

Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. Nr. 4(12). Prill 2007 Çmimi: 30 lekë

"Dibra në kornizë"

Shënime në
1-vjetorin e gazetës

Nga **BUJAR KAROSHI**

Një miku im, si shumë prej jush, bleu si çdo vit 50 kalendarë "Dibra" dhe ua dhuroi miqve e shokëve të tij për Vitin e Ri! Këtë vit, njëri prej tyre ishte edhe një plak i vjetër nga Kalaja e Dodës. Plaku, pasi e falënderoi njëherë për kalendarin - dhuratë, u ngrit, e përqafoi edhe disa herë të tjera, pasi pa se në kalendar ishte botuar një fotografi e "Fushës së Ponairit", në Korab. "Më zgjate jetën!" - thotë plakun me lot në sy. - Më ke sjellë gjithë Dibrën në shtëpi. Unë do ta vendos këtë kalendar në krye të dhomës!"

E nisa kështu këtë shkrim, për t'ju kujtuar lexuesve të gazetës "Rruga e Arbërit" dhe shumë miqve e shokëve tanë, se, megjithëse jemi larg, një copë Dibrë e kemi gjithmonë me vete. Por, këtë Dibrë që kemi me vete, është ajo Dibra që kemi lënë, dikush para '90-ës dhe dikush pas '90-ës, e ndoshta ndonjë tjetër e ka lënë ditët e fundit ose mendon ta lërë.

Organizimi ynë në shoqata, me simbol Dibrën, ka një qëllim: Të kthejë vëmendjen e opinionit, vendimmarrës ose jo, në drejtim të Dibrës, në mënyrë që ajo të mos braktiset, në mënyrë që ata njerëz që kanë mbetur atje, që çdo ditë e më shumë sfidojnë varfërinë, të kenë një vend ku "të kapin" shpresën për të jetuar.

Në këtë kuptim, kam menduar dhe vazhdoj të mendoj, se përfshirja ime dhe e shumë prej nesh në një shoqatë me synim nxitjen e zhvillimit të iniciativave për Dibrën, do të na jepte mundësi gjithsecilit prej nesh të jepnim kontributin tonë në këtë drejtim.

Këtë mendim, një vit më parë ma përforcoi edhe z. Rakip Suli, me të cilin, edhe privatisht, kemi shkëmbyer mendime e opinione për mënyrën e funksionimit të shoqatës në përgjithësi dhe gazetës në veçanti.

(Vijon në faqen 2)

Të gjithë së bashku për rrugën e progresit

Nga **SAKIP CAMI - FAQE 3**



Hyrja e Rrugës së Dibrës në sheshin "Skënderbej", Tiranë

Foto: Bashkim Lleshi

26 MAJ, KUVEND TEKNIKO - SHKENCOR PER "RRUGËN E ARBËRIT"

Aktualisht, organizatorët kanë hartuar programin e aktivitetit dhe po punohet për përpunimin e materialeve, në mënyrë që të bëhen sa më të kapshëm për pjesëmarrësit dhe publikun, si dhe po punohet për mbledhjen e fondeve për zhvillimin normal të aktivitetit.

MË HOLLËSISHT NË FAQEN 2

Financuesit e gazetës "Rruga e Arbërit" Nr.1-12

"Rruga e Arbërit" mbushi 1 vit. Me këtë rast, e ndajmë të domosdoshme të bëjmë publikë personat që kanë bërë të mundur botimin e saj. Deri tani ata kanë qenë anonim për lexuesin, por nuk duhet të mbeten të tillë. Ata, që mbajtën gazetën gjallë për një vit rresht, janë biznesmenët dhe intelektualët dibranë:

- | | |
|-----------------|--------------|
| 1. Rakip Suli | 195 000 lekë |
| 2. Musa Rriçku | 195 000 lekë |
| 3. Shaban Bitri | 50 000 lekë |
| 4. Huzri Hoxha | 40 000 lekë |
| 5. Faik Bruçi | 30 000 lekë |
| 6. Sali Shira | 150 Euro |

Gazeta "Rruga e Arbërit" ka gjetur mbështetje të vazhdueshme financiare tek zotërinjtë Musa Rriçku dhe Rakip Suli, të cilët jo vetëm që kanë dhënë mbështetjen kryesore për gazetën, por kanë qenë edhe mbështetësit kryesorë të veprimtarive të Shoqatës LID, gjatë vitit të parë të veprimtarisë së saj. Redaksia falënderon donatorët e gazetës për mbështetjen. Gjithashtu, falënderojmë edhe z. **Gazmend Kërkuti** nga qyteti i Dibrës së Madhe me banim në SHBA, i cili ka bërë të mundur publikimin e gazetës falas në Internet në faqen "www.dibra.org", si dhe z. **Naim Buci**, i cili ka shtypur falas suplementet e katër numrave të fundit të gazetës.

NË BRENDËSI

Mundësitë e zhvillimit të Lurës
FAQE 4-5

Ambasadorja amerikane në Shkup vizitoi Dibrën e Madhe
FAQE 7

Holanda, 4.6 mln euro për zhvillimin e verilindjes
FAQE 6

Faik Ballanca dhe fryma moderne në tregimin shqiptar
FAQE 7

Një jetë në botën e letrave
FAQE 9

"Luftëtar i paepur për liri"
FAQE 8

Visare nga oda dibrane
Çdo lis ka rrënjën e vet
FAQE 12

ABONIME

Në mënyrë që gazeta "Rruga e Arbërit" të jetë sa më pranë lexuesit, redaksia njofton se kanë filluar abo nimet për muajt **Maj - Dhjetor 2007. (8 numra)**

ABONIMI NË GAZETË PËR KËTË PERIUDHË KUSHTON 400 LEKË.

Abonimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: **Cel: 068 31 19 232** ose në numrat fiks **(04) 357 179; 233 283.**

Abonimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "**Fleta XXI**", pranë Gjimnazit "**Said Najdeni**", me nr. **tel: 0218 4233.**

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

Duke bërë abonimin tuaj, ju bëheni pjesë e gazetës!

Ju kujtojmë se nga numri 13-të e në vazhdim, çmimi i gazetës do të jetë 50 lekë

“Dibra në kornizë”

(Vijon nga faqja 1)

Mendimet e projektet e tij më kanë dhënë të kuptoj se, ndoshta kjo shoqatë, në ndryshim nga të tjerat, do të kishte të bashkuara dy anët e medaljes: Iniciativat dashamirëse për Dibrën dhe mbështetjen financiare, pa të cilën nuk mund të bëhet asgjë. Për të mos u keqkuptuar, mbështetja financiare nuk duhet kuptuar si mundësi, nga e cila ne duhet të përfitojmë. Jo, përkundrazi, mbështetja financiare është garanci, për t'u dhënë shtysë punëve, që ato të dalin me cilësi dhe të kapshme e të ndjeshme për publikun.

Këtë koncept, redaksia e gazetës është munduar ta zbatojë gjatë një viti punë. Duke kuptuar se një gazetë, në fillimet e saj, ka dhe vështirësi, kemi menduar disa herë gjatë procesit të përgatitjes, se gazeta nuk do të kishte të ardhme, por, sapo vinin materialet e radhës dhe ndonjë konsultë e shpejtë në redaksi, na bënin të mendonim se gjërat po përmirësoheshin numër pas numri. Dhe kjo ndodhi vërtet. Në numrat e parë, miq e shokë tanët, jo larg shtypit, nuk ishin optimistë në jetëgjatësinë e gazetës. I kemi kundërshtuar vazhdimisht këto opinione negative dhe mendoj se, deri tani, në këtë përvjetor të gazetës, ne, të gjithë së bashku, kemi arritur t'i përcjellim opinionit një anë tjetër të dukjes së gazetës: Një rritje të saj në drejtim të cilësisë, duke e afruar me standardet e shtypit të sotëm.

Por, tani, pas një viti, “Rruga e Arbërit” ka nevojë për më shumë bashkëpunëtorë, për më shumë lexues e për më shumë energji. Në këtë kuptim, dua të shpreh disa shqetësime e probleme për vazhdimësinë normale të gazetës.

Së pari, për problemin e shpërndarjes dhe abonimeve.

Personalisht, duke qenë se kam përgatitur për shtyp shumë gazeta të ngjashme me gazetën e shoqatës sonë, kam menduar që e jona të jetë e një stadi më të lartë. Në ndryshim nga të tjerat, kam menduar që gazeta “Rruga e Arbërit” të gjejë treg, jo të dhurohet apo falet. Unë nuk jam kundër parimit të faljes së gazetës, por jam kundër parimit të faljes së gazetës atij që nuk e lexon, atij që nuk është i interesuar për të ose më e keqja, atij që e lexon përciptazi dhe pastaj gjykon përciptazi. Prandaj, shtirja e abonimeve është një rrugë e mirë dhe e sigurt, në mënyrë që gazeta të shkojë sa më shpejt tek lexuesi.

Problemi i dytë lidhet me shtimin e bashkëpunëtorëve. Në 12 numra gazetë, numër pas numri, bashkëpunëtorët janë rritur. Jo vetëm brenda vendit, por edhe nga jashtë, nga Amerika e Suedia. Natyrisht, me shtimin e bashkëpunëtorëve është e nevojshme edhe shtimi i numrit të faqeve të gazetës. Në këtë kuptim, për të mos rritur shpenzimet financiare, është i nevojshëm, ndoshta, “sakrifikimi” i ngjyrave. Ngjyra në një gazetë duhet të jetë fjala e shkruar. Një pjesë, sado e vogël, e botuar nga gjithkush, është një përgjegjësi e madhe dhe një nder, natyrisht.

Shtimi i bashkëpunëtorëve lidhet edhe me problemin e hapjes së gazetës. “Rruga e Arbërit”, në 12 numra jetëgjatësi, ka qenë gjithmonë një gazetë e hapur. E hapur, në kuptimin e përfshirjes në debat për çështje e probleme të ndryshme, por edhe e hapur, në kuptimin e një dritareje, ku çdo dibranë të gjejë hapësirën e tij për të shkruar. Kështu, “Rruga e Arbërit” mbetet, tani pas një viti, më shumë se kurrë, një gazetë që pret shkrime. Pret shkrime nga gazetarët e vjetër dibranë, pret shkrime nga historianët dibranë, pret shkrime nga komunarët e rinj, drejtuesit vendorë të Dibrës, Bulqizës, Matit e Tiranës, në mënyrë që gazeta të bëhet një vend debati. Atje ku ka debat, ka edhe progres.

Dashuria jonë për Dibrën nuk ndryshon. Të gjithë e duam njëlloj; njëlloj ne, njëlloj edhe ju, ashtu si dhe plaku që donte “një copë Dibrë”, varur në dhomën e tij. Por, në ndryshim nga ai, ne nuk na mjafton “Dibra në kornizë”, ne kemi shumë gjëra për të bërë për të, në mënyrë që ta kemi Dibrën më pranë, në të gjitha ditët e vitit. Ndaj, edhe këmbëngulja jonë për nxitjen e frymës për ndërtimin e “Rrugës së Arbërit” vazhdon të rritet dita-ditës.

Këtë shkrim po e mbyllim me një thënie të bashkëpunëtorit tonë, Gazmend Kërkutit, nga Amerika: “Në përgjithësi, të gjithë dibranët mundohen që ëndrra e “Rrugës së Arbërit” të bëhet realitet. Mos harro: KONTRIBO... Të paktën, fol me miqtë e tu për këtë temë, ngri zërin për këtë projekt! Gjërat nuk bëhen brenda natës..., kuptohet, por, të paktën, të përpiqemi të çojmë këtë ëndërr një hap përpara, drejt realizimit.”

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI**

Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**

Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala**

ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave “Gintash”, Laprakë.

Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.

Email: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës “Lidhja e Intelktualëve Dibranë”.

Shoqata “Lidhja e Intelktualëve Dibranë” ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001 . Euro 13-661344-0102 . USD 13-661344-0203

26 maj 2007, KUVEND TEKNIKO - SHKENCOR PËR “RRUGËN E ARBËRIT”

Me nismën e disa intelektualëve dibranë dhe me mbështetjen e shoqatës “Lidhja e Intelktualëve Dibranë”, në bashkëpunim edhe me tre shoqata me qendër në Tiranë, Peshkopi e Dibër të Madhe, më 26 maj 2007, në një nga mjediset e Hotel “Tirana International” në Tiranë, organizohet një Kuvend shkencor mbi “Rrugën e Arbërit”.

Shoqata LID ka përcaktuar komisionin qendror organizues të Kuvendit, komisionin tekniko – shkencor dhe sekretarinë e Kuvendit, të cilët po merren aktualisht me përgatitjen e materialeve për konferencën, përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme, në mënyrë që Kuvendi të përcjellë pranë opinionit publik dhe instancave vendimmarrëse argumentet e domosdoshme për ndërtimin sa më shpejtë të “Rrugës së Arbërit”.

Komisioni qendror organizues përbëhet nga zotërinjtë: Nuri Abdiu - kryetar, Bashkim Lleshi - zv/kryetar si dhe anëtarët, Iljaz Kaca, Shpetim Cami, Rakip Suli, Musa Ricku, Shaban Bitri, Preng Doci, Shaqir Skarra. Ndërsa komisioni tekniko-shkencor përbëhet nga Inxhinierët: Faruk Kaba - kryetar, Bashkim Lleshi, zv/kryetar si dhe anëtarët Avni Dibra, Ilir Alliu, Vesel Hoxha, Naim Karaj, Tofik Jegeni. Si sekretar të Kuvendit organizatorët kanë zgjedhur: Ilir Strazimiri, Hysen Uka dhe Bujar Karoshi.

Në fazën përgatitore organizatorët kanë hartuar programin e aktivitetit (të detajuar më sipër). Aktualisht po punohet për përpunimin e materialeve, në mënyrë që të bëhen sa më të kapshëm për pjesëmarrësit dhe publikun, si dhe po punohet për mbledhjen e fondeve për zhvillimin normal të aktivitetit. Deri tani, shumë biznesmenë dhe qytetarë dibranë kanë konfirmuar

PROGRAMI

Ora 9³⁰ Prezantimi i Kuvendit Tekniko-Shkencor

Prof. Dr. **Nuri Abdiu**, Kryetar i Shoqatës “Lidhja e Intelktualëve Dibranë”, Tiranë

Ora 9⁴⁰ Përhëndetje për Kuvendin Tekniko-Shkencor

Shpëtim Cami - Kryetar i Shoqatës “Votra Dibrane”, Dibër e Madhe.

Iljaz Kaca - Kryetar i Shoqatës “Nisma Dibrane”, Peshkopi.

Prof. As. Dr. **Arjan Kadiu** - Kryetar i Shoqatës “Bashkësia Dibrane”, Tiranë.

REFERATET

Ora 10⁰⁰ Prof. Dr. VALTER SHTYLLA: “Rruga e Arbërit, rruga kryesore e vendit, krahas rrugës “Egnatia” që në lashtësi”.

Ora 10²⁰ Dr. Inxh. FARUK KABA, Inxh. PIRO BEDO, Prof.Dr.

BASHKIM LLESHI, Dr. ORHAN SAKIQI, Inxh. TOFIK JEGENI, Inxh. OLSET HAXHIU, Inxh. SHPRESA HASANAJ: “Studim për mundësinë e ndërtimit të rrugës së Arbërit, rruga Tiranë - Dibër.

Ora 10⁴⁰ Inxh. LLAZO ÇAKAR, Inxh. SHEFKI HALITI: “Rruga e Arbërit në territorin e Maqedonisë,Dibër-Gostivar-Tetovë-Shkup”.

Ora 11⁰⁰ Pushim për kafe

Ora 11³⁰. Dr. VESEL HOXHA ,Prof. Dr. ILIR ALLIU, Dr. NAIM

KARAJ: “Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që do të vihen në lëvizje për ekonominë e tregut me ndërtimin e Rrugës së Arbërit”

Ora 11. ⁵⁰ Inxh. AGIM SHENJATARI, Inxh. HAKI DISHA, Inxh.

ZENEL HYSA: “Pasuritë minerale të rajonit të Matit, që do të vihen në lëvizje për ekonominë e tregut me ndërtimin e Rrugës së Arbërit”.

Ora 12¹⁰ Prof. Dr. BASHKIM LLESHI, Inxh. AVNI DIBRA:

“Zhvillimi i mëtejshëm i Turizmit Malor në zonat ku do të kalojë Rruga e Arbërit”

Ora 12³⁰ Diskutime

Ora 13⁰⁰ Konkluzionet.

Ora 13¹⁰ Mbyllja e Konferencës.

donacionet e tyre për Kuvendin. Donacionet e derdhura në numrin e llogarisë së shoqatës do të bëhen publik në numrin tjetër të gazetës. Sponsorizuesit kryesore të aktivitetit do të publikohen edhe në materialet shoqëruese të Kuvendit si në ftesat e dhe botimet që lidhen me të. Personat që kanë dëshirë të kontribojnë për këtë aktivitet duhet të derdhin shumën e kontributit në numrin e llogarisë së shoqatës pranë **PROCREDIT BANK: Në lek 13-661344-0001. Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203**

Gjithashtu, njoftohen anëtarët e shoqatës si dhe të tjerë, të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në konferencë, të rregjistrojnë emrat e tyre në sekretarinë e Kuvendit për të marrë ftesën e domosdoshme për të ndjekur punimet e konferencës. Kjo për arsye të një zhvillimi sa më normal të saj.

Për informacione të tjera, organizatorët kanë vendosur edhe numrat e mëposhtëm të kontaktit:

Cel: **068 40 14 434; 068 21 29 940; 068 31 19 232.**

Tel: **(04) 233 283, 357 179.**

E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com

NJOFTIM

Shoqata “Lidhja e Intelktualëve Dibranë”, me 26 maj 2007, ora. 9.00, në Hotel “Tirana International” zhvillon Kuvendin tekniko-shkencor për “Rrugën e Arbërit”.

Në këtë kuvend janë të ftuar të gjithë anëtarët e shoqatës.

Me këtë rast, për efekt organizimi, u lutemi gjithë anëtarëve të marrin ftesat e aktivitetit.

NJOFTIM

Gazeta “Rruga e Arbërit”, njofton të gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresën tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179 / 233 283** ose të na shkruani në **E-mail: lid_gazeta@yahoo.com**



Lugina piktoreske e lumit të Tiranës, nga do të kalojë Rruga e Arbërit. Djathtas, gjurma e rrugës së vjetër. 23 prill 2007. Foto: Bashkim Lleshi

Të gjithë së bashku për rrugën e progresit

Jemi shumë të vonuar me “Rrugën e Arbërit”

Nga SAKIP CAMI

Para pak kohësh, Qeveria përgatiti dhe së shpejti do të çojë për miratim në Kuvendin e Shqipërisë ligjin “për konsensionet”. Ky ishte një lajm i mirë për të gjithë ata që mendojnë dhe luftojnë për zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Me këtë nuk dua të them se ka edhe njerëz që mendojnë për të kundërtën, por skepticizmi i tyre është tejet i dëmshëm për ne shqiptarët, që kemi humbur shumë kohë në zhvillimet demokratike dhe në ekonominë e tregut.

Menjëherë mëndja më shkoi tek “Rruga e Dibrës” ose tek “Rruga e Arbërit” ashtu siç ka filluar të thirret tani nga shqiptarët anë e mbanë vendit. Tani thashë me vete erdhi momenti, për ta ndërtuar këtë rrugë, aq të çmuar dhe të kërkuar nga shqiptarët, sepse Shqipëria tashmë ka biznesmenë të fuqishëm që e marrin përsipër ta ndërtojnë me konçension këtë rrugë, pa ja hequr të drejtën edhe firmave të huaja që do të konkurrojnë apo do ta marrin përsipër ta ndërtojnë atë. Tani është koha të mos mendojmë se kush po e bën një punë të mirë për Sh-

qipërinë, përse po e bën, sa fiton ai e pyetje të tjera cinike që na kanë lënë kaq shumë prapa. Tani është koha të ndërtojmë sa më shpejt që të jetë e mundur, të korrigjojmë sa më shpejt që të jetë e mundur, të futemi në shinat e vërteta dhe të heqim dorë nga eksperimentet pa fund në politikë dhe ekonomi.

Tani është koha të heqim dorë nga xhelozitë se kush e bëri këtë apo këtë vepër madhore për kombin se vetëm historia është ajo që do të merret me këtë problem dhe siç e dimë historia shkruhet më vonë, ndaj duhet t’ia lemë asaj të gjykojë për meritat e gjithsecilit.

“Rruga e Arbërit” është një rrugë e vjetër që ka lidhur historikisht Tiranën me Dibrën. Nuk është rrugë vetëm e dibranëve siç duan ta servirin disa për t’ia ulur vlerat, por e gjithë shqiptarëve nga Jugu në veri. Tani, aktualisht, Tirana lidhet me Dibrën me një rrugë të gjatë 183 km, në itinerarin Tiranë – Milot – Burrel – Klos – Bulqizë - Bllatë (Doganë) - Peshkopi. Me realizimin e ndërtimit të kësaj rruge, studimi i fizibilitetit të së cilës ka përfunduar, nga Tirana mund të shkohet në Dibër për një orë dhe nëpërm-

jet 72 km. Pra qytetarët dibranë brenda dhe jashtë Shqipërisë kursejnë 111 km rrugë të stërmundimshme, kursejnë kohë, para, karburant, etj., dhe mbi të gjitha largojnë lodhjen dhe stresin e rrugës së gjatë.

Leverdia ekonomike e kësaj rruge është jashtëzakonisht e madhe, pasi qytetarët e Dibrës, Strugës, Tetovës, Gostivarit, Kumanovës dhe Shkupit nuk do të shkojnë më në asnjë vend tjetër për pushime veçse në Durrës, Shëngjin, Vlorë e Sarandë. Pra në planin ekonomik nuk fitojnë vetëm dibranët por gjithë shqiptarët, vlonjatët, sarandiotët, tiranësit, durrsakët, matjanët, bulqizakët, etj.

Zotërinj deputetë e pushtetarë, Me “Rrugën e Arbërit” jemi shumë të vonuar, prandaj të mos vonohemi më. Tani nga Vendimi i Qeverisë, që mban datën 14 tetor 1996 kanë kaluar tashmë 10 vjet. Jemi në pritje të një vendimi tjetër, dhe pikërisht të miratimit të ndërtimit me konçension të kësaj rruge me rëndësi strategjike, kombëtare e ndërkombëtare, që do t’i jap një bum të paparë zhvillimit të ekonomisë dhe veçanërisht të turizmit në këtë zonë.

Për ata që nuk e njohin itinerarin e rrugës së re shpjegojmë

se ajo do të kalojë nga Tirana (Kafja e Rremës) tek Ura e Brarit (objekt muzeal me vlera të veçanta) në Shupal, Murrizë, Guri Bardhë, Ura e Vashës, Bulqizë, Shupenzë, Gjoricë me një gjatësi 72,6 km. Qyteti i Burrelit nga 98 km larg Tiranës, pas ndërtimit të kësaj rrugë ndodhet vetëm 52 km larg, Klosi nga 115 km larg, do të ndodhet vetëm 35 km larg, Bulqiza nga 131 km, do të ndodhet vetëm 51 km larg. Pra me pak fjalë dhe me pak humor, për ta do të thotë ta pinë kafën e mëngjesit në Tiranë, të mbarojnë punë dhe të kthehen përsëri e të hanë drekë në sh-tëpinë e tyre.

Kur e pyeta një shkodran se si po e ndieni veten pas ndërtimit të autostradës Tiranë - Shkodër, shkodrani si zakonisht me humor u përgjigj :” Më mirë prishet, kafën e mëngjesit, tash e pimë në Tiranë.

Tani është radha e dibranëve që ta pjekin kafën e mëngjesit në Tiranë, dhe anasjelltas.

Tani është koha të punojmë të gjithë së bashku për rrugën e progresit. Dhe sic e thamë më lart, jo vetëm për të mirën tonë, si dibranë, por për të mirën e gjithë shqiptarëve. Për të mirën e Shqipërisë!

URIME DHE MESAZHE PËR NJË VJETORIN E GAZETËS “RRUGA E ARBËRIT”

ISUF MIHA, Durrës: Nuk kam fjalë e shprehje për të uruar gazetën “Rruga e Arbërit”. I kam lexuar të gjithë numrat që kanë dalë deri tani dhe them me bindje të plotë se jeni në rrugë të mbarë. Ju, si staf gazete, keni bërë vërtet një punë të madhe. I keni dhënë Dibrës dhe dibranëve kudo që ndodhen një gazetë ndryshe, një gazetë enciklopedike. Edhe njëherë ju lumtë! Vazhdoni në këtë rrugë se patjetër intelektualët do t’i keni pas. Urime në këtë përvjetor. Jo një vit por vite e vite me radhë kemi besim se do të nderoni Dibrën dhe dibranët. Edhe njëherë sinqerisht urime!

VELO CFARKU, Tiranë: Kjo gazetë, ndonëse më e reja në tregun e shtypit, jo vetëm ka ravijëzuar fizionominë e saj, por është bërë shumë e pranishme në rrethin e gjerë të lexuesve. Ajo, sipas meje, prek probleme të një rëndësie të veçantë jo vetëm për Dibrën, por me interes të jashtëzakonshëm dhe në shkallë kombëtare. Merita e stafit tuaj është se ju i keni dhënë një profil bashkëkohor, me një paraqitje tipografike që konkurren me sukses shtypin e sotëm. Gazetën e bëjnë të cilësishme e interesante problemet që ngre, duke tërhequr firma autoritare. Kjo është meritë e stafit tuaj. Ju uroj suksese të mëtejshme!

AGIM KABA, SHBA:

Para dy diteve fola me vel-lane tim Faruk Kaba, që banon në Tiranë, dhe ai me ftoi që te asistoj në një konferencë mbi rrugën e Arbërit, për të cilën Faruku ka kryer shumë studime vite me pare. Natyrisht une punoj akoma dhe jam inxhinjer në ndërtim ketu në Amerikë si rrjedhim me gjithë deshiren e madhe nuk mundesha t’i pergjigjesha pozitivisht tim vellai. Une i dergova atij një shkrim si e kujtoj une rrugen e Arbërit apo te Dibres sic e quanim ne ne Tiranen e viteve me pare. Rastesisht ne kompjuter hasa ne kete gazete fantastike qe ju drejtoni dhe u befasova me larmine e kompetencen e shkrimeve ne te. Pamvaresisht se kam lindur ne Tirane por e gjithë familja ime ishim e jemi dibrane te kulluem, gje per te cilen jemi krenare. Do te kisha deshire te botonit shkrimin tim ne se e shihni te arsyeshme. Ne se me pergjigjeni e pranoni shkrime te tilla une mund t’ja u nis ne kete emai. ju kujtoj se kam botuar rralle shkrime te ndryshme vite me pare dhe ketu ne Amerike per gazeten llyria. Sidoqofte ju uroj shendet e pune te mbare e mire u degjofshim!

P.S. Shkrimin e z. Agim Kaba e presim të na vijë dhe do e botojmë në numrin e radhës. (Redaksia)

Mundësitë e zhvillimit të Lurës

Nga Prof. Dr. BASHKIM LLESHI

Shkak për shkrimin e këtij artikulli seshte kryerja e Studimit për ndërtimin e tre H/C të vegjël për shfrytëzimin Hidroenergjitik të lumit Molla e Lures nga Shoqëria "ERDAT Energji" Sh.p.k. me Administratorin djalin e Lures Preng Docin, studim i cili ka mbi 2 vjet që ka përfunduar dhe megjithë mungesën e madhe të energjisë elektrike në shkallë kombëtare, vetëm para dy muajsh u muar drita jeshile e miratimit nga Organet Qendrore të Pushtetit, për të filluar punën për ndërtimin e tyre.

Por si një nga njohësit e vjetër të pasurive nentokësore e mbitokësore, të bukurive natyrore, të historisë e zakoneve të Lures nuk mund të vazhdoj shpjegimin e këtij problemi pa përmendur shumë shkurt disa nga kujtimet që më janë skalitur në mendje gjatë punës time afro 40 vjeçare, për Luren e Lurjanet.

Sapo mbarova shkollën e lartë me emeruan në Ndermarjen gjeologjike të Bulqizës dhe si gjeolog i ri që isha në Janar të vitit 1969 me emeruan në Ekipin e Lures të Ekspeditës së Peshkopisë.

Për të shkruar në Lure në ato vite nuk kishte rrugë automobilistike, nga Cidhna e Lan Lura, por shkoni nga Peshkopia në Bulqizë, Burrel, Milot, Rubik, Rreshen, Kurbnesh, flinim një natë në Kurbnesh dhe të nesërmen arrinin në Lure.

Mungesa e rrugës automobilistike dhe largësia nga Bulqiza ku ishte Drejtoria e Ndermarjes gjeologjike të Bulqizës që kryente punime gjeologjike për gjithë rrethin e Dibres kanë bërë që në Lure të kryhet një volum i kufizuar punimesh gjeologjike të cilat erdhën duke u shtuar sidomos pas ngritjes së Ekspeditës Gjeologjike të Peshkopisë në vitin 1968.

Vetëm në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar me zhvillimin e sektoreve pyjore u bë e mundur lidhja e Lures me rrugë automobilistike me Peshkopinë nga Arrasi, Cidhna e Lan Lura si dhe në drejtimin tjetër nga Mbas Deja, Vanasi, Liqejt e Lures, duke u lidhur me rrugën ekzistuese që vinte nga Krej Lura në Luren e vjetër e Fushe Lure. Më vonë u hap rruga nga Krej Lura për në Pregje Lure e Arre Molle, ndërsa shumë zona si Vlashaj, Lajthiza etj. edhe sot nuk kanë rrugë automobilistike. Duhet theksuar se edhe rrugët e hapura janë shumë të veshitura, të pa mirembajtura e pothuajse të pakalueshme, sidomos ajo nga Cidhna e Lan Lura dhe rruga e Arre Molles, të cilat duan mirembajtje, riparime e përmirësime për tu përdorur.

LURA MBAN POSHTË SAJ PASURI TË MEDHA NENTOKËSORE


Në Lure punimet e para të kerkim-rilevimit janë kryer nga gjeologët Sovjetikë, më vonë janë kryer disa punime të kerkimit për krom dhe hekur nëkëll nga Ndermarja gjeologjike e Rubikut dhe në vitin 1968 filluan punimet e para të kerkim-rilevimit dhe kerkim-revizionimit nga Ndermarja gjeologjike e Bulqizës.

Në vitet 1968 e 1969 u krye rilevimi gjeologjik në shkallë 1:10 000 i masivit të Lures nga Ekipi i rilevimit të Ndermarjes Gjeologjike të Bulqizës i drejtuar nga Gjeologu dhe petrografi i vjetër dhe me eksperiencë, Agim Dobi nga Gjirakastra.

Në vitin 1969 mua më caktuan në ekipin e kerkimit të kromit në masivin e Lures.

Në Lure fillova për herë të parë të ushtrij profesionin e bukur të gjeologut. Une isha i pari gjeolog dibran që dy vitet e para të punës i bëra në Ekipin e Lures së bashku me teknikët e vjetër dibrane Ali Bardhi e Adli Baholli.

Edhe pasi u largova nga Ekipi i Lures dhe fillova punë në Bulqizë në fillim si gjeolog dhe më vonë si Krye Gjeolog i



Pamje e Fushë Lurës

Lura e malësorëve trima e të zgjuar, Lura e pasurive mbitokësore e nëntokësore dhe e bukurive natyrore, së shpejti do të jetë edhe Lura e prodhimit të energjisë elektrike

Ndermarjes Gjeologjike të Bulqizës, vazhdimisht i kam ndjekur me përparesi punimet për sqarimin e perspektivës për minerale të dobishme të rajonit të Lures, por volumet e mëdha të punimeve që kryheshin në vendburimin e kromit të Bulqizës dhe largësia nga Drejtoria e Ndermarjes Gjeologjike të Bulqizës, kanë bërë që në përgjithësi në zonën e Peshkopisë dhe në vecanti në Lure të kryhen një volum me i kufizuar punimesh të kerkim-zbulimit të mineraleve të dobishme.

Në fund të viteve shtatëdhjetë dhe në fillim të viteve tetëdhjetë kur une fillova punë në Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë dhe Minjerave, Grupi i prognozës së kromit në Institutin e bashkëpunim me Ndermarjen gjeologjike të Bulqizës, pas Studimit të prognozës së masivit me perspektivë për mineralin e kromit, atij të Bulqizës, kreu Studimin për perspektivën dhe prognozen për krom të masivit të Lures, dhe po në ato vite une përgatita Disertacionin për doktraturë në fushën e gjeologjisë dhe jo rastesisht e kam zgjedhur temën e disertacionit për masivin e Lures, por sepse edhe ky masiv ashtu si dhe masivet e tjere ultrabazike lindore të vendit tone janë perspektive për krom dhe minerale të tjera të dobishme, dhe sqarimi i metejshej i perspektivës së tyre varet nga shkalla e intensifikimit të punimeve gjeologjike të kerkim-zbulimit.

Në ato vite edhe Studimi i kryer për Luren nga Instituti në bashkëpunim me Ndermarjen e Bulqizës, një studim i planifikuar nga shteti në zbatim të orientimeve të kohës për të punuar në masivet me perspektivë e të pa shkelur u përdor si një argument për të më cilësuar se kisha sabotuar dhe isha në kundërshtim me orientimet sepse kisha hequr grupin e Institutit me qëllim nga Bulqiza, për të punuar në "Luren time" sic u shpreh në ato kohë një drejtues kryesor partie e shteti i asaj kohe etj. Për këtë dhe disa probleme të tjera të sajara me larguan në ato vite nga Instituti, por nuk u desh shumë kohë por vetëm 3-4 vjet për të sqaruar gjithçka e për të vertetuar e kundërt dhe une, nga i dërguar, nga ish udhëheqja e Ministrisë për edukim në Gjeologjinë e Tiranës, brenda 4 vitesh, kolektivi i kesaj Ndermarje, kundërshtoi kandidaturën e sjelle nga udhëheqja e Dikasterit për Drejtor të Ndermarjes dhe më zgjodhi mua të drejtoj këtë ndermarje, dhe një pjesë të vendosmerisë time ia dedikoj edhe viteve që kam punuar e mesuar

në Lure.

Pas kryerjes së këtij studimi në masivin e Lures u gjetën edhe dy vendburime të reja ku filloi shfrytëzimi i kromit, në Hurdhat e Tolles dhe në Mbas Deje.

NE KERKIM – ZBULIMIN DHE VLERESIMIN E PASURIVE NENTOKËSORE TË RAJONIT TË DIBRES NE PERGJITHËSI DHE ZONES SË LURES NE VECANTI KANE DHENË NJË KONTRIBUT TË MADH E TË RENDESISHEM SPECIALISTET GJEOLGJE DIBRANE

Edhe sot që kam mbushur rreth 40 vjet që punoj në sektorin e gjeologjisë i kujtoj vitet që kam punuar e mesuar në Lure. Vazhdimisht e kujtoj Luren e bukur të pasurive minerale të kromit në Blac, Kumbull, Krej Lure, Hurdhat e Tolles, Mbas Deje, Lajthize e Dodaj, hekur-nikelit e nikelit silikat, nga Lajthiza deri në Nome, të bakrit në zonën Pregje Lure – Arre Molle, të gureve dekorative ofiolitike e karbonatike etj. që janë përshkruar mjaft mirë në botimin e muajit shkurt 2006 të gazetës "Rruga e Arberit" nga gjeologu i vjetër e pasionant dibran Dr. Vesel Hoxha i cili është një ndër specialistet dibrane që ka dhënë një kontribut të madh e të rëndësishëm si gjeolog dhe drejtues i Ekspeditës Gjeologjike të Peshkopisë për shumë vite, që së bashku me shumë inxhinjerë të tjerë dibrane si Sefedin Qorlaze, Hasan Hajdari, Gani Gurra, Esat Manjani, Selim Muca, Sakip Elezi, Nexhat Hysa, Sefedin Shabani, Ilir Alliu, Sabri


Hoti, Saim Keta, Veip Gjoni, Naim Karaj, Agim Mazreku, Adil Alku, Bujar Toci, Emrulla Kolgjini, Mustafa Manjani, Myftar Islami Xhemal Mena etj. apo teknikët e vjetër të gjeologjisë si Nexhat Lami, Enver Vorfi, Dilaver Miftari, Rasim Hyseni, Arif Nesimi, Ali Bardhi, Naim Muca, Adli Baholli, Dogjan Dervishi, Ramazan Paci, Xhelal Suli, Ali Spahiu, Nazif Aga, Qamil Ndreka, Ahmedan Shkurta, Ymer Toluli, Fatmir Alla, Skender Likalla, Irfan Agolli, Sherife Bodurri, Vjollca Snalla, Muharrem Sturce, Ramazan Sulejmani, Isa Mandri, Kalosh Dedja, Nexhmije Keshi, Hasan Lala etj. etj. që të gjithë së bashku kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në njohjen e pasurive nentokësore të rajonit të Dibres etj.

ME NDERTIMIN E RRUGES DURRES – KUKES – PRISHTINË EDHE PARKU I MADH TURISTIK I LURES DO TË JETË ME AFER TIRANËS E DURRESIT DHE DO TË SHFRYTËZOHET ME SHUMË NGA TURISTET E VENDIT DHE ATO TË HUAJ

Kujtoj Luren e bukur të liqejeve, kujtoj liqenin e Luleve, liqenin e Zi apo liqenin e Madh, kujtoj fushën e Pelave, një fushe e bukur në mes të pishave e mbuluar me bar sikur të ishte një tapet i madh me ngjyrë jeshile, fushën e bukur të Vanasit e Gurin e Vashes, kujtoj perroin e bukur të Molles së Lures me ujë të kristal që furnizohet nga liqejt dhe bjeshket e Lures, kujtoj keto bukuri të rralla natyrore të cilat deri më sot nuk janë shfrytëzuar nga turistët vendas dhe të huaj, por me ndërtimin e rrugës Durrës – Kukës – Prishtinë edhe Lura ky park i madh turistik i vendit tone do të afrohet me Tiranën e Durrësin duke i dhënë një hop të madh zhvillimit të turizmit malor.

Kështu për tu lidhur me aksin kryesor të kesaj rruge që do të kalojë në grykën e Fanit të Vogël do të duhen vetëm 25-30 km rrugë, pra parku i madh i liqejeve turistike të Lures do të jetë afër këtij aksi kryesor rrugor vetëm 25-30 km nga të cilat, 15 km. nga Liqejt e Lures në Krej Lure dhe në zonën e Oroshit janë rrugë ekzistuese që kërkon vetëm përmirësime ndërsa vetëm 10 km. nga Krej Lura në Nenshejt e Bisake ose Krej Lure – Bulshar – Reps duhet të hapen rrugë e re. Me ndërtimin e kesaj rruge do të shkohet nga Tirana deri tek liqejt e Lures për 2 ore, duke e afruar këtë park të madh turistik Kombëtar me Tiranën dhe Durrësin.

Edhe ndërtimi i rrugës së Arberit do të afroje Parkun e madh Kombëtar të Lures me Tiranën e Durrësin duke vazhduar nga Klosi në Lis, Vinjoll, Mbas Deje në Gurin e Vashes, e duke vazhduar neper pjesën jugore të Parkut turistik të Lures në pjesën jugore të tij deri tek liqejt e Lures.



Pamje e Kreje Lures.



Pamje e Liqenit të Zi

► LURA KA NXJERRE VEPRIMTARE TE SHQUAR TE PUSHKES, TE MENDJES E TE PUNES.

Ne Lure u njoha jo vetem me terrenin por edhe me historine e Lures, me njerezit, me malesoret e zgjuar, trima e te urte te Lures, me malesoret qe ishin pasardhesit e Llesh Nikoll Docit, prijesis te 300 Duvakeve te kuq, te Kol Bib Docit, Hasan Kaces e Halil Menes te Lidhjes se Prizrenit, te Ali e Sufe Menes dhe Deme Perlekes qe dhane jeten per mbrojtjen e Shkodres nga Serbo-Malazezet, te Dom Nikoll Kacorrit, Nen Kryetar i Qeverise se Pare Kombetare te Ismail Qemalit, te Komandantit Ibrahim Gjoci, bashke-luftetar i patriotit Elez Isufi kunder Serbeve, te Heroit te Popullit Gjoke Doci qe dha jeten per cilirimin e vendit, me malesoret qe ishin te zote te pushkes, te punes e te kuvendit qe ishin te zote te kuvendonin edhe ne kuvendet e burrave.

Lura me beri qe ne moshe te re te njihem me jo vetem me gjeologjiine, por edhe me historine e saj.

Ne ato vite patrioti dhe nacionalisti dibran, Aqif Lleshi nje nga kreret e Dibres, qe cdo vere vinte per pushime ne fshatin e tij te lindjes ne Zogje, kur mori vesh se me kane caktuar me pune ne Lure u gezua dhe filloi te me tregonte per Luren duke me thene se edhe paraardhesit e fshatit tone Marku, Leka dhe Lleshi, 3 djemte e Zogjut nga ka marre edhe emrin fshati Zogje, kane ardhur nga Lura dhe per kete udha ne veri te fshatit Zogje qe shkon per ne Gjuras e Selishte quhet Udha e Lures, sepse Zogju me 3 djemte i larguar nga Mirdita sipas te dhenave te hereshme, ka pushuar nje nate tek miqte e tij ne Lure, te nesermen ka udhetuar gjithë ditën drejtimit te Gjures Lures, liqejve dhe pyjeve te Lures dhe kur kane kaluar ne zonen e pa njohur prej tyre, te Lukanit e te Selishtes i ka zene nata. Pas mesnate ato kane zbritur nga Prati e Gjuras ne Livadhet e Epra te Zogje, ku jane ulur per te pushuar dhe kur ka zbardhur dita kane pare rruget nga kishin zbritur, duke thene se kjo eshte Udha qe kemi ardhur nga Lura, sepse fshatrat nga kishin kaluar naten si Lukanin, Selishten e Gjurasin nuk i njihnin dhe sot e kesaj dite ajo udhe mban emrin Udha e Lures.

Aqif Lleshi si pjesemarrës i Kuvendit Historik te Lures, me ka folur per Vendimet e rendesishme te ketij Kuvendi pluralist, me ka folur per Lurjanet, per burrat e Lures qe kane marre pjese ne kete kuvend, krahas krereve te tjere nacionaliste te Dibres e Shqiperise se Veriut si, Ibrahim Gjoci, Bajram, Tahir e Llan Mena, Hazis Arifi, Preng Gjergji e Gjon Biba, Met Hoti etj.


Qysh ne ato vite dhe me vone u njoha me veprimtaret e shquar te Lures qe punonin ne organet drejtuese te pushtetit dhe te ekonomise te rrethit te Dibres ne qytetin e Peshkopise, ne Lure dhe ne zona te tjera si: Gjon Deda, Ahmet Perleka, Lek Rajta, Ahmet Kacorri, Osman Murati, Sali Ajazi, Ramadan Ajazi, Bib Doci, Hilmi Kolgjegja, Bajram

Cuku, Dali Buci, Ramazan Vladi, Mustafa Doci, Nikoll Kola e Ndue Kola, Isuf Murati, Maliq Buci, Dod Vladi, Bardhok Rajta, Skender Perleka, Musa Vladi, doktoret Ndrec Vladi e Preng Doci, ushtaraket Gjergj Vladi e Ali Koceku e shume te tjere, qe punonin e punojne jo vetem ne Lure por ne gjithë vendin, u njoha me kuadrot drejtuese qe punonin ne ato vite ne Lure si: Nezir Buci, Ali Leka, Osman Musa, Sherif Peka, Murat Vladi etj.

Me kujtohet Sherif Peka, nje burrë i urte, fjale pak, i zgjuar e punetor, ish Kryetar i Kooperatives se Armmolles, qe sa here vinte ne Krej Lure e Lajthize, vinte e na bente ndonje vizite tek Cadrat e Gjeologjiise ku ne jetonim dhe ne Tetor te vitit 1970 kur ne Lajthize kullosnin tufat e deleve te ardhura nga Lezha, mileshtin afro 200 dele dhe jepnin vetem 1-2 kg. qumesht, Sherifi u kishte lene porosi barinjve qe deri kur delet te japin 1 kg. qumesht, ate do ta ndani pergjysëm, 0,5 kg. do ta dergoni tek cerdhja e femijeve ne Drobaj te Lajthizies dhe 0,5 kg. do tua dergoni gjeologeve qe jetojne ne Lajthize ne cadra.

Edhe sot pas rreth 40 vjetesh nuk mund te harroj punetoret e gjeologjiise te cilet kane punuar ne Blac, Krej Lure, Kesule te Lures, Kumbull e Lajthize ne vitet 1969 e 1970, si Pjeter Rajta, Gjergj Rajta, Vlash Kacorri, Mark Ndue Doci, etj. nga Krej Lura, Skender Docin e Rustem Cukun nga Fushe Lura, Zjarmetarin Ali Buci nga Vlashaj, minatorin dhe armatorin e talentuar Mark Lleshi nga Lajthiza e Pertejme, Mark Nikollin e Gjergj Gjonin nga Drobaj, Pal Qokun nga lagja Qokaj, Jonuz Peken nga Arre Molla e shume te tjere.

Nuk mund te le pa kujtuar malesoret e zgjuar, trima, te urte e te mencur te ketyre aneve si Tat Gjyshin e Drobajve me automatik qe ruante dyqanin, Lal Pjetrin e urte te Drobajve, Ndue Qokun nga Qokaj, apo Lal Deden e Lajthizes se pertejme, me gjoksin e hapur e me trup te gjate e te fuqishem qe te dukej si ndonje Dragua nga ato qe tregohen ne perralla, qe pjesen me te madhe te kohes e kalonte ne kasollen ne perrua ne Lajthizen e pertejme, apo Kol Bushin e Pregj Lures, nje plak i mencur qe dinte te ndante kanun e te kuvendonte ne kuvendet e burrave.



PAMJE E LIQENIT TE MADH

Kur shkoja per te kontrolluar punimet ne Dodaj, kaloja nga Arre Molla neper Lagjen Sumaj siper nje shtepie te madhe afer perroit te Dodajve qe nga banoret vendas mesova se ishte shtepia e Malesorit te zgjuar, trim e bujar, Llesh Zef Docit.

Me Llesh Zefin, une kur isha ne Lure, nuk mu dha mundesia te takohesha sepse ai ne ate kohe punonte Kryetar i Lokalitetit ne Zall Dardhe dhe si malesor i drejte e i ndershem qe ishte ne sistemin e kaluar ka patur edhe perplasje e peripeci te shumta, por malesoret e atyre aneve ma kishin pershkruar, portretin e tij ashtu sic ishte, nje burrë i gjate me trup te fuqishem, trim, te zgjuar dhe mikpritës. Shume vite me vone jam takuar me Llesh Zefin ne Tirane dhe kur jam takuar per here te pare me doli parasysht ai burrë malesor qe me kishin pershkruar bashkefshataret e tij shume vjet me pare.

Ne Tirane u njoha dhe me 4 djemte e Llesh Zefit me Prengën i cili punonte bashke me mua ne Gjeologjiine e Tiranës ne profesionin e topografit, me Doden, Deden dhe Gjonin te cilet u shkolluan ne Tirane ne vitet tetedhjetë, duke banuar ne shtepine e Vellait te madh Prenges ne nje hyrje nje dhome e nje guzhine ne Koder Kamez.

Ne vitet e para te demokracise, djemte e Llesh Zefit, nen drejtimin e Inxhinjerit te ndertimit, Dode Docit, formuan Kompanine "LURA", nje nder Kompanite e para te ndertimit qe ushtron aktivitetin e saj ne Tirane, Durres e Lezhe.

Nga malli qe kane per vendlindjen e tyre dhe te te pareve te tyre, paveresisht nga largesia per aresye komunikacioni, ato vazhdimisht organizojne guida turistike per vehte dhe shoket e miqte e tyre, per te kaluar ndonje feste, si ajo e Shen-Kollit dhe Shen Merise, festa tradicionale te Lures, apo ndonje dite pushimi ne zonen e bukur te liqejve te Lures.

Keto jane malesoret qe jeten e tyre e kane te lidhur me Luren, me vendlindjen e tyre. Kjo dashuri per vendlindjen i ka bere djemt e Llesh Zef Docit te mendojne per zhvillimin e Lures, Kjo dashuri per vendlindjen e beri djalin e madh te Llesh Zefit, Preng Docin, Drejtuesin e Shoqerise "ERDAT Energji" Sh.p.k. e krijuar ne vitin 2004, te ndermarre studimin Hidroenergjitik te lumit Molla e Lures, qe

Lura e pasurive nentokesore e mbitokesore, Lura e liqejve dhe bukurive natyrore te kthehet edhe ne burim energjie jo vetem per Luren por edhe per vendin.

LURA E PASURIVE MBITOKESORE E NENTOKESORE, LURA E TURIZMIT E BUKURIVE NATYRORE SE SHPEJTI DO TE JETE EDHE LURA E PRODHIMIT TE ENERGIJE ELEKTRIKE.

Pasi u njoha me interesimin e kesaj Shoqerie per ndermarrjen e ketij investimi, une si njohes i zones se Lures ne fund te vitit 2004 perfundova Studimin "Mbi kushtet gjeologo-inxhinjerike dhe hidrologjike te lugines se lumit Molla e Lures" per realizimin e Skeme-ideese se shfrytezimit energjitik te ketij lumi dhe me kerkese te po kesaj Shoqerie ne Janar te vitit 2005, Instituti Hidrometereologjik perfundoi Studimin "Hidrologjia e Hidrocentraleve te Lures" nga studjuesit Prof.As.Dr. Vangjel Mustaqi, Msc. Safet Sula dhe Inxh. Hidroteknik Daniel Shuaipi.

Kryerja e ketyre dy studimeve sherbeu si baze qe Specialistet Inxh. Leonard Kacinari dhe Inxh. Bardhok Rajta, djali i Veprimtarit te shquar te Lures, Lek Rajta, nga Krej Lura te hartojne "Parashtresen teknike mbi projekt-idene e shfrytezimit hidroenergjitik te lumit Molla e Lures" ne rrethin e Dibres.

Mbeshtetur ne kushtet Hidrologjike, Topografike, Gjeologo-inxhinjerike dhe Hidroenergjitike ne lumin Molla e Lures eshte parashikuar te ndertohen 3 Hidrocentrale te vegjel, H/C "Lura 1" ne Krej Lure, H/C "Lura 2" ne Arre Molle dhe H/C "Lura 3" ne Gjure Rec. Per te tre keto H/C jane perpiluar "Parashtresat Teknike mbi Projekt – Idene e cdo H/C me vehte si dhe Plan – Biznesi perkates me treguesit kryesore tekniko-ekonomike dhe te prodhimit te energjise.

Ne H/C "Lura 1" ne Krej Lure eshte parashikuar te investohen rreth 345 milion leke dhe do te prodhohet nje sasi energjie vjetore prej 13 500 000 Kwh.

Ne H/C "Lura 2" ne Arre Molle eshte parashikuar te investohen rreth 398 milion leke dhe do te prodhohet nje sasi energjie vjetore prej 19 000 000 Kwh.

Ne H/C "Lura 2" ne Perroi i Lajthizes eshte parashikuar te investohen rreth 280 milion leke.

Ne H/C "Lura 3" ne Gjurre Rec eshte parashikuar te investohen rreth 484 milion leke dhe do te prodhohet nje sasi energjie vjetore prej 18 200 000 Kwh.

Ne te tre H/C parashikohet te investohen rreth 1 507 milion leke duke parashikuar te prodhohet nje sasi energjie vjetore prej rreth 50 700 000 KWh.

Mbeshtetur ne keto te dhena, ne kushtet e mungeses se energjiise elektrike ne vendin tone eshte e pa faleshme qe per studime te tilla te zvarritet miratimi i tyre per gati mbi 2 vjet nga Organet Qendrore te Pushtetit, gjoja per plotesim te Legjislacionit per Konkensionet.

Me lidhjen e Lures me rruge te re me aksin kryesor te rruges Durres- Kukes- Prishtine dhe me ndertimin e ketyre Hidrocentraleve do te marre nje hop te ri zhvillimi ne zonen e Lures.

Lura, kjo perle e turizmit tone malor me pasuri te rralla mbitokesore, ky park kombetar i shkaterruar dhe i pa shfrytëzuar deri me sot, se shpejti do te behet nje vend ku do te kalojne ujkendet dhe pushimet turistet e vendit dhe ato te huaj.

Lura, kjo zone me nje nentoke te pasur do te shtojë oreksin e biznesmenëve te vendit dhe te huaj per te investuar per venjen ne qarkullimin ekonomik per ekonomine e tregut te pasurive nentokesore te kromit, hekur nikelit e nikelit silikat, bakrit, gureve dekorative etj. e te gjitha keto do te arrihen kur nepermjet ndertimit te rruges se re, Lura do te afrohet me Tiranen dhe Durresin, kur me ndertimin e ketyre Hidrocentraleve, Lura do te prodhoje energji per vehte dhe per vendin, pra rruga dhe prodhimi i energjiise do ti japin nje hop te ri zhvillimit ekonomik te zones se Lures.

LAJME

nga shtypi i përditshëm

Holanda, 4,6 mln euro për zhvillimin e verilindjes

Paratë do të jepen për projektet e bashkive dhe komunave të Dibrës

Pas dy vjet përpjekjesh të përbashkëta, më në fund është hapur drita jeshile, për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi midis ambasadës holandeze, Këshillit të Qarkut Dibër dhe Organizatës Holandeze për Zhvillim, SNV.



Kështu, përpara dy ditësh, në qytetin e Peshkopisë është bërë promovimi i kësaj marrëveshje, sipas të cilës qeveria holandeze, do të financojë 4,6 milionë euro, për investime në bashkitë dhe komunat e Qarkut të Dibrës. Këto investime do të bëhen në projekte që do të përzgjidhen sipas një numri kriteresh të përcaktuara më parë. Bashkitë dhe komunat që do të aplikojnë për të marrë mbështetje financiare nga ky program, duhet të kontribuojnë me 30 deri në 40 për qind të vlerës së projektit me fondet e veta. Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta (EKN) do të financojë afërsisht 3,6 milionë euro për Fondin e Besuar. Ambasada do të financojë edhe për fuqizimin e kapaciteteve të menaxhimit të qeverive lokale në një shumë prej 0,5 milionë euro. Në këtë mënyrë, kontributi total i ambasadës holandeze për këtë projekt kap shifrën 4,1 milionë euro për tre vjet. Ndërkohë, Organizata Holandeze për Zhvillim, SNV, me seli në Tiranë dhe me tre zyra rajonale, nga të cilat një në Peshkopi, do të ofrojë ekspertizën e vet për ngritjen e kapaciteteve të njësive të pushtetit vendor nëpërmjet këshilltarëve të saj të specializuar. Vlera e kësaj ekspertize llogaritet në afro 500 mijë euro. Është hera e parë, që aplikohet një program i tillë tregalësh, me synimin për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për zhvillimin rajonal. Kjo marrëveshje i hap rrugë zbatimit të një programi 3-vjeçar, që fillon në muajin prill 2007 dhe përfundon në 2010. Në këtë promovim, kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, Naim Gazidede, tha se “besoj dhe jam optimist, se ne do të bëjmë të mirën më të madhe të mundshme dhe se do jemi tepër të përgjegjshëm për realizimin e këtij programi”. Ndërsa ambasadori holandez tha se “Dibra me zbatimin e këtij programi, do të bëhet shembull në të gjitha qarqet e tjera të vendit”. Më tej, ai theksoi se “ky program nuk duhet të ketë risk politik, por të gjejë bashkëpunimin e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Qarkut, pavarësisht ngjyimeve politike të tyre, për t’u realizuar me sukses”. (SHQIP)

Dhjetëra vatra zjarresh pushtojnë malet e Dibrës

Janë dhjetëra vatra zjarresh, që kanë pushtuar malet në rrethet e Dibrës dhe Bulqizës, ku mbi dhjetëra hektarë pyje janë pushtuar nga flakët. Kështu, janë vërejtur vatra të këtyre zjarreve, në pyjet e dushkut mbi fshatin e Vajkalit në qytetin e Bulqizës, në Malin e Bardhë mbi 1400 metra mbi nivelin e detit, mbi fshatin Koçaj, në komunën e Fushë-Bulqizës dhe vazhdon gjeografia e shtrirjes së këtyre zjarreve, në pyjet e Tërnovës, Strikçanit, Ramnagorës në zonën e Gollobordës e në vazhdim deri në kodrat me pyje dushku mbi fshatin Gjoricë, ku siç duket nuk ka ngelur pa u infektuar edhe pyje të Maqedonisë në lindje të lumit të Drinit të Zi, në fshatin Gjoricë të rrethit Bulqizë. Nga këto dhjetëra vatra zjarresh të rëna në këtë rreth, më e fuqishmja padyshim që ka qenë ajo e rënë në pyjet e dushkut, mbi fshatin Strikçan, të komunës Zerqan, ku gjatësia e vijës së këtyre zjarreve, shkon në mbi 1 kilometër dhe dëmi i shkaktuar nga djegia, bëhet mjaft i konsiderueshëm. Përveç pyjeve të rrethit Bulqizë, flakët dhe tymi ka pushtuar edhe male të tërë në rrethin e Dibrës. Kështu, në këtë rreth, dhjetëra vatra zjarresh, kanë pushtuar malet e Pratis në komunën e Selishtës, si dhe në malet mbi fshatin Bllatë e Sipërme dhe Kërçisht, në komunën e Maqellarës, në kufi me Maqedoninë. (SHQIP)

Ulja e temperaturave dëmtoi drurët frutorë

Trashësia e dëborës në qytetet Peshkopi dhe Bulqizë, ka shënuar 2 centimetër në fund të muajit të kaluar, ndërsa në lartësinë mbi 1000 metra mbi nivelin e detit, ajo ka shkuar mbi 10 centimetra. Në të tilla kushte, nuk bëhet fjalë për bllokim rrugësh, por gjithsesi rënia e saj nuk mund të shpërfillët totalisht, pasi më e pakta mendohet që ajo të ketë shkaktuar dëme të lehta të drufrutorët. Sipas specialistëve të bujqësisë në këto rrethe, bora ka shkaktuar dëmtime në prodhim, veçanërisht për kumbullat dhe dardhat, të cilat rezultojnë të kenë çelur plotësisht. Banorët mbeten të shqetësuar, pasi ulja e temperaturave e shoqëruar me ngrica, do të shkatërrojë prodhimin e kumbullave dhe të dardhave, ku Dibra është mjaft e përmendur. (SHQIP)

Intervistë me drejtorin e spitalit rajonal të Peshkopisë zotin Ardian Bitri

Pyetje: A nuk ka interes për lexuesit të dinë pak mbi historikun e spitalit të Peshkopisë.

Përgjigje:Bërthama e parë e spitalit të Peshkopisë shënon vitin 1927 me një kapacitet prej 8 shtretër. Mjek ishte Ihsan Korça i cili shërbente njëkohësisht si mjek për të gjithë rrethin e Dibrës. Spitali ishte vendosur në shtëpinë e Ashim Xheladinit, e më vonë në atë të Shyqyri Gjymishkës, ku qëndroi deri në vitin 1939. Si mjek gjatë këtyre viteve kanë punuar Myrteza Aliu e Vasil Rako. Në vitin 1939 spitali kaloi në shtëpinë e Abdurahim Kuckës ku kapaciteti u rrit në 13 shtretër dhe kishte gjithsej 8 dhoma. Si mjek kanë punuar: Shefqet Nokuqi, Xhavit Xheta, Theodhor Papavrami, Thoma Harito (në periudha të ndryshme).

Në vitin 1945 me rritjen e kërkesave, spitali transferohet në shtëpinë e Imer Maliqit-lagje “Dublec”, ku kapaciteti u rrit me 30 shtretër, përveç kësaj gjatë luftës meqënëse trajtoheshin edhe shumë partizan u morrën disa dhoma për shtrim dhe edhe tek hoteli i Ramiz Trepçës. Si mjek gjatë kësaj periudhe kanë punuar: mjeku italian Saviako Mikeli (si pathallog, pediater + infeksionist), Avdul Shendulli i cili solli dhe aparatet e parë të roscopisë që përdorte vetë, Tahsim Karagoji, Koco Deda, Aristotel Thoma që erdhi në vitin 1947. Dine Mahmuti ishte mikroskopisti parë. Infermier ishin: Nebi Dule, Njazi Kucka, Xheli Cena Jak Limani (Jakupi), si mami ishte një italiane Thomai dho Nothnadi, farmacist Ivzi Baholli, guzhinier Tofik Sturçe e Veli Koka, shofer Demir Arifi.

Më vonë filluan të përgatitën kuadro të ulët mjekësor si infermier, mami, farmacist etj., kështu në vitin 1947 në spital filloj punë Xhemal Kaca-sekretar llogaritar, Fahri Kadiu sekretar, Iljaz Palushi teknik rogneni, Fatbardha Kuqi dhe Ulvika Trepça infermiere.

Në vitin 1948 fillojnë punë në spital Myslim Shehu magazinier, Qemal Shamku, Xheladin Tahiri, Njazi Rushiti e Ali Deda infermier.

Në vitin 1949 fillojnë punë si infermier Fehmi Agolli, Mukades Balla, Lirie Reka, ndërsa Shefqet Domi laborant i mesëm ku më vonë vazhdon fakultetin e mjeksisë ku pas mbarimit specializohet mjek laborant, Margarita Mezelxhiu e Zeliha Trepça ishin mamitë e para dibrane.

Në vitet 1951-1952 mbarojnë kursin e infermierisë të tjerë që tani filluan të shpërndahen edhe nëpër fshatra e zona të rrethit të Dibrës si: Bilal Ooku, Hamdi Cala, Nevzat Shehu Skënder Fida, si edhe Sabri Haliti laborant, Leonora Palushi mami. Në vitin 1953 erdhën nga kursi i infermierisë së Tiranës edhe shumë infermier të tjerë si Hamid Seferi Dilaver Gjoni, Sehit Deshati, Halit Murati, Xhevdet Zerja, Sabetin Mura, Abaz Shehu, Ramazan Gjeci, Muharrem Zajmi, Luigj Baraj, Eli Kuqi, Mehmed Loka Anila Vejushi, Myslim Cami, Fiqiri Izvira, Rasim Toci, Sabri Cuni etj kurse mami erdhi Nezhmije Shehu.

Po në këtë vit spitali u trans-

ferua nga shtëpia e Imer Maliqit në spitalin e ri që u bë këtë vit me një kapacitet prej 120 shtretër ku u ndanë dhe specialistët si: Pathologjia 35 shtretër, Kirurgjia 40 shtretër, Pedriatia 30 shtretër, infektivi 15 shtretër, laborator klinik biokimik etj. Mjekët që kanë punuar në këtë periudhë janë: Hysni Rusi, Lluca Dhimitri, Koco Poro, Piro Velo, Simon Capeli, Xhavit Konci, Rushen Golemi, Skënder Pustina, Mark Mirashi, Naun Theodhosi. Më vonë filluan të dalin kuadrot e parë dibrane nga Universiteti i Tiranës, Ahmet Alliu njihet si mjeku i parë dibran që filloi punë në vitin 1959, më pas vazhduan kuadrot e tjerë si: Mehdi Cani, Ahmet Kamberi, Irfan Jashari, Lame Koci, Fehmi Agolli, Ahmet Shadinaj, Shefqet Domi Luiza Sula, Xhavit Myftari, Muhamet Kodra, Sulejman Zhugli.

Me 4 maj të vitit 1974 spitali kalon në ndërtesën e re (që është edhe sot) me kapacitet 320 shtretër, që në atë periudhë ishte ndër spitalet më të mirë jo vetëm nga madhësia por edhe nga funksioni: pajisjet rregull, disiplina e pastërtia, por nga cilësia e mjekimit dhe ajo e operacioneve, nga niveli i lartë shkencor i përgatitjes së mjekve të këtij spitali nga gjiri i të cilit kanë dalë disa doktorë shkencash e deri në pedagog në shkencat e mjekësisë të Universitetit të Tiranës siç janë: Mehdi Cani, Ahmet Kamberi, Veli Zogu, Sulejman Zhugli, Rahim Gjika, Muhamed Kodra, Bazri Neziri, Mira Neziri Si rezultat i paisjes me mjete e aparatura të nivelit bashkëkohor, të përgatitjes së specialistëve pothuajse të gjithave fushave, në spitalin tonë janë diagnoistkuar, trajtuar apo janë bërë ndërhyrje kirurgjikale shumë të vështira. Aktualisht këtu kryhet një gamë e madhe analizash dhe ekzaminime e të tjera: gjë e cila ka bërë të mundur që mbi 95 % e të sëmurëve tonë, të diagnostikohen e trajtohen në këtë spital. Kohët e fundit në spitalin tonë po operon një fondacion Norvegjez, i cili pas hartimit të masterplanit të këtij spitali, tani ka filluar zbatimin i tij në praktikë, mbarimi i të cilit do të bëjë që spitali ynë të radhitet ndër spitalet më të mirë të vendit. Së shpejti do të inagurohet ndërtesa tjetër e re e quajtur ndërtesa e shërbimit “Nëna e fëmija” ku do të kalojë shërbimi i obsetrikë-gjinekologjisë, i prematurancës, pediatriisë, distrofikut si dhe të aneskeve të tyre. Kjo do të shënoje dhe mbarimin e fazës së parë të masterplanit, për të vazhduar më pas në godinën aktuale, rristrukturimin e saj dhe paisjen me të gjitha mjetet e duhura. Përsonei i lartë dhe i mesëm që kanë shërbyer gjatë periudhës 1954-2001 në spitalin tonë do ti gjeni sipas reparteve përkatëse që ka spitali.

Pyetje: Çfarë personeli ka sot spitali rajonal i Peshkopisë?

Përgjigje: Spitali i Peshkopisë në planin strategjik është emërtuar si spital rajonal që nënkupton, mbulimin me shërbim spitalor të të gjitha specialiteteve për zonën e Dibrës, Bulqizës dhe Burrelit. Ka 295

shtretër të ndarë në katër shërbime kryesore Patologji, kirurgji, obstetric-gjinekologji, pediatri. Duke u nisur nga numri i specialistëve që punojnë në këtë spital, aftësitë e tyre, niveli i aparaturave mjekësore që përdoren, madhësia dhe cilësia e ambjenteve, ky spital e ka justifikuar emrin e tij si rajonal dhe i ka të gjitha mundësitë për të qenë i tillë me planin strategjik.

Ka një mbarëvatje për tu marrë shembull në furnizimin me medikamente dhe materiale mjekimi, furnizimin me ujë, dritë, ngrohje, me veshje të krevatit, veshje të sëmurit, ruajtjes së higjienës dhe pastërtisë, në respektimin e disiplinës në punë, në gadishmerinë e raportit të urgjencës.

Pyetje: Çfarë investimesh janë bërë vitet e fundit në spitalin e Peshkopisë?

Përgjigje: Gjatë viteve të fundit janë bërë investime serioze në këtë spital. Shkurtimisht po përmendim investimin nga NORVAK të ambjenteve të dy godinave prej rreth një milion euro, investim tjetër i departament të shtetit Amerikan që ka bërë ndërtimin e godinës së vjetër, prej 147 mijë dollarësh, investim i Ministrisë së Shëndësisë në rikonstrukcionin e pjesshme të sistemit të ngrohjes godina e re prej 5.3 mil lek, investime në pajisje mjekësore si eko, grafi, pajisje të laboratorit etj. Megjithatë jo se janë përmbushur të gjitha nëvojat reale për investime në këtë spital. Ka edhe mjaft probleme që presin zgjidhje. Këtë vit presim realizimin e projektit të rikonstrukcionit të godinës së spitalit infektiv dhe kthimin e saj në poliklinikë, projekt ky i qeverisë Italiane. Duke realizuar këtë projekt zgjidhim problemin e të sëmurëve të infektivit që është për të ardhur keq për gjëndjen mizerabel të këtyre ambjenteve aktualisht, dhe eliminojmë fluskin e të sëmurëve në spital aq problematik për mirëmbajtjen e tij. Të tjera investime presin në shtimin e pajisjeve bashkëkohore, në sistemin e mirëmbajtjes së godinave të spitalit, në sistemin dhe rrethimin e jashtëm të tij etj

Pyetje: A gjen vend shprehja “pagaaj të shëroresh” në spitalin e Peshkopisë?

Përgjigje: Etika dhe sjellja e personelit mjekësor me të sëmurët apo dhe me shoqëruarit e tyre them me binjë se ka qenë në nivel të mirë në krahasim me rastet e shumta që fliten në shtyp për shërbimin mjekësor në spitalet e tjer. Nuk them se nuk kemi patur raste të shkeljes së etikës mjekësore por dua të them se përgjithësisht punohet në mënyrë korrekte. Për raste të vecanta jemi ndaluar seriozisht. Ky tregues i etikës mbetet për tu përmisuar më shumë dhe përbën një sfidë të kohës. Sfidat e tjera të spitalit tonë mbeten mungesa në disa specialist si domosdoshmëri për të realizuar një shërbim sa më të kompletuar dhe bashkëkohor.

Ju faleminderit për interesimin tuaj. Do të jem i hapur për çdo kënd që interesohet të dijë për mbarëvatjen e spitalit tonë.

**INTERVISTOI:
MIRVET LALA**

KRONIKË NGA DIBRA E MADHE**Ambasadorja amerikane në Shkup, Xhulian Millovanoviq vizitoi Dibrën e Madhe****Zhvillim i bashkëpunimit edhe në të ardhmen**

Ambasadorja amerikane bëri përrurimin e asfaltimit të rrugëve në lagjen Qernanicë, ku përveç tjerëve ishin të pranishëm edhe autoritete vendore Ambasadorja e SHBA-ve në Shkup Xhulian Millovanoviq, e shoqëruar nga Patrisha Rajner, drejtore e USAID-it në Maqedoni dhe Villiam Althaus, shef i projektit të decentralizimit, të enjten qëndroi për një vizitë pune në Dibër. Ambasadorja Millovanoviq fillimisht u prit në ambientet e komunës nga kryetari Argëtim Fida dhe kryesuesi i KK, Nizamedin Papraniku, ku u bisedua për situatën aktuale në komunën e Dibrës, procesin e decentralizimit dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Pas kësaj ambasadorja amerikane bëri inagurimin e asfaltimit të disa rrugëve në Lagjen “Qernanicë”, ku përveç tjerëve ishin të pranishëm edhe Myftiu i Dibrës Mr. Ruzhdi Lata dhe përfaqësuesi i kishës orthodoxke, Dositej Blagoja Spirovski. Ismailaki Ologu, duke përshëndetur mysafirët në emër të banorëve të lagjes së asfaltuar, tha se: “ndima financiare e SHBA- nëpërmjet USAID-it bëri që banorët e kësaj lagje pas njëzet viteve të shpëtojnë nga balta, pluhuri dhe ndotja e ambientit”. Argëtim Fida, duke u falenderuar për investimet e USAID-it në disa projekte në Dibër, shtoi se: “banorët e kësaj lagje me organizimin dhe pjsëmarrjen e tyre e ndjejnë decentralizimin dhe afërsinë me pushtetin vendor. Dibra dhe SHBA kanë mishërim të lidhjeve shpirtërore sepse jemi të vëllazëruar me Komunën e Staten Islandit në Nju Jork, ku jetojnë e punojnë afër 15 mijë mërgimtarë dibranë. Ne si pushtet vendor ftojmë ambas-



Ambasadorja e SHBA-ve në Shkup Xhulian Millovanoviq dhe kryetari i Komunës së Dibrës, kryetari Argëtim Fida, gjatë inagurimit të asfaltimit të disa rrugëve në Lagjen “Qernanicë”

adoren Millovanoviq që t'i bashkangjitet aksionit tonë që amerikanët me origjinë nga Dibra, një pjesë të kapitalit të tyre ta investojnë në Dibër përmes zonës së re për zhvillim ekonomik. Ai me këtë rast i dhuroi ambasadores një libër Kongresi i Dibrës 1909 dhe Pllaketën e qytetit. Xhulian Millovanoviq, theksoi se: “Jam e impresionuar me realizimin e këtyre projekteve në bashkëpunim me banorët për të zgjidhur njërën nga problemet. Ky aktivitet është dëshmi e procesit të decentralizimit. Që nga viti 1993 populli amerikan nëpërmjet USAID-it në Maqedoni ka investuar 450 milionë dollarë, gjatë periudhës së tranzicionit që bazohet në decentralizimin, ekonominë e tregut dhe shoqërinë multietnike. Në këtë frymë ne do të bashkëpunojmë edhe në të ardhën. Mysafirët gjatë qëndrimit-

it të tyre në Dibër u takuan edhe me këshilltarët e Këshillit të Komunës dhe vizituan Shtëpinë karakteristike dibrane të Ibrahim Erebarës, Qendrën për diagnostifikim të kancerit në gji “Florina Marku-Rusi” dhe linjën për prodhimin e jufkave “Isen Komerc”. Gjatë bisedës me gazetarë ambasadorja Xhulian Millovanoviq, deklaroi se: “Pata kënaqësinë që sot këtu të njihem nga afër me rezultatet e shkëlqyera të bashkëpunimit mes USAID-it dhe pushtetit vendor. Kjo dëshmon rëndësinë praktike të decentralizimit. Vizitova edhe shtëpinë karakteristike dibrane si trashëgimi kulturore historike, Qendrën për diagnostifikim të kancerit dhe një linjë për prodhimin e brumërave, fitova përshtypje shumë të mira dhe shpresoj në bashkëpunimin e mëtejshëm edhe më të suksesshëm”.

“Qeveria s'ka të drejtë t'i ndërpresë punimet”

Segmenti rrugor Dibër-Zhironvicë në drejtim të Shkupit dhe ai rrugor Dibër-Gllobocicë në drejtim të Strugës, janë dy segmentet që pasqyrojnë ashpërsinë e ish-sistemit monist ndaj Dibrës. Në këto dy segmente në gjatësi prej 24 km rruga është e gjerë vetëm 5m, ndërsa më tutje rruga vazhdon me gjerësinë normale prej 6m. Njëzet e katër km e rrugës Dibër-Zhironvicë përveç ngushtësisë janë edhe shumë të dëmtuara, me gropa, pa rrjeta celiku në shkëmbinj të anësore, që mundësojnë shembjen e gurëve dhe paraqesin rrezik për automjetet që qarkullojnë në drejtim të Shkupit dhe nga Shkup në Dibër. Argëtim Fida, kryetari i Komunës së Dibrës lidhur me këtë rrugë, deklaroi se “fillimisht mund të them se ndërimi i garniturave qeveritare nuk duhet t'i hedh poshtë idetë progresive. Me insistimin e vazhdueshëm të pushtetit vendor në Dibër, Qeveria e mëparshme nëpërmjet firmës “Cakar” hartoi projektin për zgjerimin e segmentit rrugor Dibër-Zhironvicë”. Për këtë nga Buxheti i Maqedonisë u akorduan 1 milion euro për kryerjen e punimeve të dheut, të mureve anësore dhe të kanaleve të ujit nga Ura e Boshkut e deri te ndarja e rrugës për në Zhironvicë. Ky projekt pati dy variante, njëri me ndërtimin e një tuneli dhe dy urave që do të kushtonte 5,5 milionë euro dhe i dyti pa tunele e ura, që do të kushtonte 4 milionë euro. Qeveria e kaluar e Maqedonisë si fazë e parë në vitin 2006 akordoi 1 milion euro, duke premtuar se në vitin 2007 do të akordohen edhe 1,5 milionë euro dhe në vitin 2008

edhe 1,5 milion euro për ta përfunduar realizimin e këtij projekti. Duke folur për favorret e këtij zgjerimi të rrugës, Argëtim Fida, shtoi se “me paratë e akorduara firma “Imako” filloi kryerjen e punimeve për zgjerimin e kësaj rruge. Sipas këtij projekti në segmentin ku rruga të jetë 6 m, ndërsa në kthesa, zgjerimi i rrugës sipas mundësive të terenit do të jetë edhe deri 8 m. Kjo do të mundësojë që automjetet në këtë segment rrugor të qarkullojnë më lirshëm dhe më shpejt. Kjo me siguri do ta shtojë atraksionin për të udhëtuar në këtë zonë, zhvillimin e resurseve turistike lumore, liqenore, ekonomike, të Banjave termominerale etj. dhe do ta aktivizonte më shumë edhe vendkalimin kufitar të Bllatës. Sa i takon ndërprerjes së papritur të punimeve në këtë segment rrugor, kryetari Argëtim Fida, deklaroi se “për fat të keq punimet e filluara në vjeshtën që shkoi edhe pse dimri që shkoi ishte i favorshëm për vazhdimin e punimeve, ato cuditërisht u ndërpreën dhe me sa duket ato para u orientuan diku tjetër”. Ndërprerja e punimeve tani e ka bërë më të rrezikshme këtë pjesë të rrugës për automjetet, sepse mund të fillojnë erozionet dhe shembjet tokësore. Për fat të keq në Buxhetin e Maqedonisë për vitin 2007 për këtë segment rrugor nuk u nda asnjë investim. “Apeloj te Qeveria aktuale, te institucionet përkatëse, te deputetët dhe intelektualët, që të mos lejojnë pengimin e zgjerimit të këtij segmenti rrugor”, tha në fund kryetari i komunës së Dibrës, Argëtim Fida.

Rexhep Torte**Tre shkrimet e mësipërme janë marrë nga www.dibra.gov.mk****FAIK BALLANCA DHE FRYMA MODERNE NË TREGIMIN SHQIPTAR**

Nga KLARA KODRA

Tregimtarin Faik Ballanca mund ta quash me plot gojë një nga shkrimtarët që sollën frymën moderne në tregimin shqiptar, që e pasuruan atë me përmasat e lirizmit dhe psikologjizmit që në vitet 60 dhe arritën kulmin në vitet 70.

Nismëtari i parë i modernitetit në tregimin shqiptar qe, pa dyshim, Migjeni. Gjithsesi ky prozator ka qenë në thelb përfaqësues i realizmit kritik të cilin e shartoi me elemente të drejtimeve moderniste të shekullit të njëzetë. Në vendosjen e bazave të tregimit modern në letërsinë shqiptare kontribuan në mënyrën e tyre Koliqi dhe Kuteli.

Këtë traditë do ta ndërpriste drejtimi i realizmit socialist që me rregullat e veta i ngjante një neoklasicismi më të ngurtë se vetë klasicizmi. Tradita e viteve 30 do të vazhdohej nga prozatorë të talentuar të viteve 60. Faik Ballanca qe njeri prej tyre.

Tregimet e tij ishin shumë larg nga skemat e drejtimit letrar të realizmit socialist me heroin pozitiv në qendër, me manikeizmin e ndarjes në “pozitivë” a “negativë” dhe skemën e fundit “optimist” që qe në thelb një lloj i ri “hepi-endi”.

Personazhet e Ballancës në përgjithësi e ke të vështirë t'i ndash prerazi në “pozitivë” apo “negativë”, ata janë mbi të gjitha njerëzorë, pasqyrojnë dallgëzimet e shpirtit të njeriut, dialektikën e këtij shpirti që s'është as i bardhë, as i zi, po zotëron në vetvete një larmi të pafund ngjyrash që peneli i prozatorit origjinal i fikson në një spektër të shumëllojshëm.

Një tregim tipik në këtë drejtim është “Njerka”, një tregim që thyen skemat tradicionale dhe depërton thellë në zemrën njerëzore me një frymë humanizmi. Dy personazhet kryesorë të këtij tregimi që paraqiten në një farë mënyre si antagonistë nuk janë, njeri pozitiv dhe tjetri negativ, kanë secili “të vërtetën” e vet.

Personazhi rrëfimtari, vajza jetime, ka të drejtë që përjeton me dhimbje ardhjen e një të huaje që do të zëvendësojë nënën dhe njerka ka gjithashtu të drejtë të ketë lumturinë e vet familjare. Në ndeshjen e dy personazheve njeri me tjetrin atëherë kur konflikti arrin pikën kulminante dhe vajza në vend që t'i japë mirëseardhjen njerksë duke ngritur doll, shpreh hapur armiqësinë e vet ndaj saj (dhe do të ishte më se e përligjur që edhe personazhi tjetër t'ia kthente në të njëjtën mënyrë), përkundrazi ndodh një e papritur që e befason lexuesin, po që ka logjikën e vet të brendshme, një “logjikë të ndjenjës”: i ashtuquajtur personazh antagonist tregon empati ndaj personazhit tjetër, përpiket të vihet në vendin e tjetrit, të kuptojë dhimbjen e saj. Rrëfimtari nuk e shpreh këtë fillimisht me fjalë, po me një gjest kuptimplotë: njerka *qan* bashkë me vajzën e gjetur. Dhe fundi i tregimit nuk është “hepi – endi” i zakonshëm për tregimet e asaj kohe, po një “fund i hapur”, dy personazhet do të përpiqen të kuptojnë njeri-tjetrin.

Ky tregim spikat për diçka të veçantë. Ai fokusohet me këndvështrimin e protagonistes rrëfimtare (edhe njerka fillimisht portretizohet përmes optikës së këtij personazhi si “e shëmtuar”, ndonëse objektivisht kishte tipare të bukura), po në fund kapërcehet ky këndvështrim. Gjestet dhe fjalët e personazhit janë ato të një njeriu me zemër të madhe, pra shpirtërisht të bukur.

Pozitiv apo negativ është heroi kryesor i tregimit “Perëndia i shtëpisë”? Ai ka një karakter të fortë, një madhështi stoike që sfidon vdekjen (vdes në këmbë në kuptimin fizik të fjalës). E megjithatë ai ka pikëpamje patriarkale, maskiliste, është një “diktator i vogël” në sferën e familjes që nuk ngurron të lëndojë edhe në çastin e fundit gruan që s'i dha fëmijë (“...Ti ma nxive jetën”) dhe t'i urdhërojë të tëra gratë e shtëpisë të mos martohen.

Shefi i tregimit “Ma mbaj pak pallton, çun!” s'është shefi burokrat tradicional, është një njeri i guximshëm dhe stoik që e jeton dhimbjen në heshtje dhe në fillim nuk kuptohet nga rrëfimtari-personazh të cilit i mungon përvoja e jetës dhe i sheh njerëzit sipas skemash të paravendosura.

Te “Kaleidoskopi” rrëfimtari personazh e pranon të drejtën e dashurisë për vete, po nuk kupton asgjë nga ç'ngjet në shpirtin e së motrës.

Shumë tregime të F.Ballancës kanë një fund “të papritur”, që s'është megjithatë artificial, që nuk i “thyen” karakteret, nuk ia nënshtron dëshirës së shkrimtarit, po zbulon diçka që kishte mbetur në errësirë gjatë tërë zhvillimit të subjektit dhe befasi i ndriçon karakteret dhe situatat me dritë të re.

Tregimet e Faikut janë në dukje të thjeshta, të zakonshme, po shumë të thella në theksuesinë e veprimt që nuk bie në kundërshtim me rrymën e brendshme lirike. Ato dallohen për frazën e shkurtër, koncize, pa asgjë të tepërt, me një ritëm dinamik që i ngjan ritmit të jetës.

Forma e tregimeve të Faikut është në harmoni me mesazhin, në dukje e thjeshtë, po e *papërsëritshme*, kishte vullën e padukshme të origjinalitetit që u ka siguruar një vend të veçantë në tregimin shqiptar dhe që bën që ato të mbeten të gjalla pas më tepër se tridhjetë vjetësh.

28 VJETORI I VDEKJES SE ATDHETARIT JONUZ MAJTARA

Nga Ibrahim EGRIU
Malme (Suedi)

Elegji-Xha Nuzit

**Ijeshi e shend konakut i ke dhënë,
të burgosën sorrat,që deshën me
t'ngrënë
vujate dënimin larg në Goli Otok,
për të mos dorëzuar as miq'
as shok'!**

Jonuz Majtara

Në prill 1979, pushoi së rrahuri zemra e patriotit te shquar dibran, e luftëtarit të paepur për liri, zemra e të burgosurit shumëvjeçar politik, zemra e mentarit dhe e filozofit popullor në Trevën e Dibrës—Jonuz Majtara, të cilit me nderime të mëdha iu bënë homazhet nga mijëra dibranë, që u nda në përgjithmonë prej tij, me kujtimet dhe mbresat më të mira.

Fjala e tij e mprehtë dhe e matur, besnikëria, bujaria dhe trimëria ishin tiparet e Mixhës Jonuz, të cilat në tërësi përbënin një mozaik të etikës e të karakterit të tij të lartë e njerëzor.

Luftëtar i paepur për liri

- Duke filluar nga viti 1941 e deri në mbarim të luftës së Dytë Botërore ka qenë pjesëmarrës aktiv në luftën kundër pushtuesve për çliri min e Shqipërisë dhe të trojeve të okupuara shqiptare. Ai, kishte dëshirë të zhurritur që pas mbarimit të luftës, t'i plotësohet ëndra e tij e kahmotshme e t'i sheh njëhehër e për gjithmonë, të gjitha trojet shqiptare të shkëputura padrejtsisht nga trangu amë, i bash kangjiten Shqipërisë etnike, por dhe ai, si shumë luftëtarë të tjerë të lirisë që i zhgënjyer dhe, s'i shijoi çastet e vërteta të lirisë së plotë e të bashkimit etnik të shqiptarëve.

Pas mbarimit të luftës, pushtatarët maqedonas filluan ndjekjet, burgosjet, torturimet dhe shfarosjet e luftëtarëve e të atyre pak intelektualëve, që gjindeshin në atë kohë, e përse? - Vetëm se i kanë pasë takuar Partisë Nacional - Demokratike apo ishin bashkëluftëtarë të trimit të Madh, - Xhemë Gostivari, i cili ishte tmerr ndaj armiqëve dhe patriot i përbetuar i popullit tonë. Ai ishte 2 m. e 20 cm i lartë dhe kurrë s'e qëllonte plu mbi. Xhema ish nga natyra tepër i drejtë dhe asnjëherë s'bënte krime. Ishte luftëtar i pa epur për liri dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare.

Këtë e dëshmojnë qindra e mijëra shqiptarë, të cilët, përshkak të tij i patën patën futur nga 30 - 40 vetë nëpër dhomat e ngushta te barakat për rreth lumit Vardar, që ishin hermetikisht të mbyllura, duke i torturuar e asgjësuar shqipta rët, pa gjykim, pa vendim e pa dëshmi. Sipas të dhënave të dëshmitarëve të zënur peng e që i shpëtuan më së keqes, pra vdekjes, deklaroinin: - Po të mos kish ardhur që të ndërhyjë tek pushtetarët maqedon Komandanti i Brigadës Shqiptare -Qemal Agolli dhe vëllau i tij -Nexhati - Komesar, të gjithëve do na shfarosnin.

Më 1962 isha mësues në fshatin Tërnovë. Rreth atyre masakrave, ja se ç'më rrëfeu atëherë në besim, plaku 75 vjeçar-Kamber Tahiri:

Nëpër baraka, të rrethuara në të gjitha anët me ushtri e polici, ishim të zë nur robër rreth 3000 shqiptarë. Ishte tmerr e lemeri. S'dinim se ç'ndodh me ne! Prisnim vetëm se kur të na vjen radha e të na asgjësojnë. Bashkëluftëtarët e mij, nxirrreshin një nga një, torturoheshin pa masë dhe nuk kthenin më. Disa pushkatoheshin, kurse disa therreshin me anxhar. Me këtë detyrë, xhandarët, i kishin ngarkuar disa jevgji (romë).

Mirë po ç'ndodhi?!-Një rom, të cilin poashtu e kishin urdhëruar që të bëjë masakrime ndaj shqiptarëve, ai me

këmbngulësi, u kap me të dyduart për një shtyllë të barakës dhe nuk deshte të zbatojë urdhërin që t'i therrë shqiptarët. Në ato çaste iu ofru ofruan dy xhandarë dhe me anxharët (thikat) e pushkëve ia pren të dyja duart romit, me që s'deshte të kryejë kasapanë ndaj shqiptarëve. Ai, nga dhëmbja bërtiste me të madhe:

-Më vranë!-Na vranë!-Në ato çaste, britmës dhe ulurimës së tij iu bashkangjitën dhe qindra e mijë ra britma të tjera, me thënien:-Pse na vrisni?! – Kështu që, sipas dëshmitarëve okularë, ato britma janë dëgjuar rreth 25 km. larg ,përtej Mavrovës, për rreth fshatrave:Vrutok, Zhirovjan, Simnicë e gjetkë, më njohtoi plaku 75 vjeçar-Xha Kamberi. Mandej vazhdoi: -Të nesërmen, kish ardhur Komandant Qemal Agolli, i cili kish reaguashpër kundër pushtetarëve shovinist se çfarë masakrime kryen ndaj shqiptarëve dhe, prej asaj dite, një numër të madh të brugosurish na liruan. Në mesin e tyre isha dhe unë, tha ai.

Edhepse, Xha Nuzi ishte pjesëmarrës aktiv në luftën për liri, çlirim dhe bashkim të trojeve etnike ai, pas lufte, përsëri ishte i ndjekur këmba-doras nga pushteti i sapo formuar monist-maqedon. Përveç tij, në shënjestër ishin të dy vëllezërit dibranë: -Qemal e Nexhat Agolli, të cilët, siç përmenda më lart, për shkak të ndërhyrjes së tyre tek pushtetarët maqedonas që të mos e masakrojnë popullatën shqiptare të Pollogut, u asgjësuan pa nam e pa nishan. Mandej, vijon burgosja dhe toturimi çnjerzor i intelektualit dibran, Ministrit të Parë shqiptar, më 1946-Xhafer Kodra, vëllau i historianit të shquar, prof.dr. Masar Kodra, i cili nga torturat e marra u dërgua në Spitalin Psikiatrik të Shkupit dhe vdiq në moshën më të mirë, atëherë kur i nevoitej më tepër Atdheut. Menjëherë, pas tij, më 1949, u dënua 9 vjet e gjysëm burgim, Mësuesi i popullit-Esat Menzelxhiu, i cili, më 1992 mori Dekoratën Naim Frashëri. Ai, në oborrin Shkollës “Hoxhë Vokrrri”, vetëm pse deklaroi para nxënësve se, Dibra është pjesë e Shqipërisë, atëherë xhandarët e rrëm byen me dhunë dhe s'u kthye në shkollë më. Pas vuajtjes së dënimit, ai rreth një dekadë punoi si mësues në Kastriot të Kosovës dhe gëzonte autoritet të madh në popull.Vdiq më më 1968 ku, dhjetramijëra qytetarë nga të gjitha viset, i bën omazhe këtij Mësuesi të po pullit dhe u ndanë për të fundit herë me nderime të mëdha prej tij.

Pati shumë e shumë burgosje dhe u ndërmorën masa të ndryshme represive ndaj shqiptarëve, jo vetëm në Dibër, Gostivar e Tetovë, por edhe nëpër viset tjera të ba nuara kryesisht me shqiptarë.

Pas asgjësimit të vëllezërve Agolli, burgosjes së Mësuesit të popullit - Esat Menzelxhiu dhe tronditjen psikike, që ia shkaktuan intelektualit, juristit dhe Ministrit të drejtësisë - Xhafer Kodra, më 1952, pushtetarët shovinist, pa asnjë preteks e vënë në shën jestër atdhetarin - Jonuz Majtara, vetëm se deshte që shqiptarët bashkohen shpirtisht, fi zikisht dhe etnikisht. Ai, energjikisht kundërshtoi të bëhet vegël qorre e OZNES (e shërbimit sekret ishjugosllav), andaj ndaj tij u ngrit aktpadijë me motivacion: - “Agjitacion për bashkim me shtetin amë, pra, me Shqipërinë”.

Pushtetarët e shfrenuar sllavomaqedonas kishin drojë nga autoriteti i tij që gëzonte në masë, nga mençuria e tij dhe nga oratoria e tij, tipare që i kish dhunti nga na tyra. Për një fjalë goje nëpër ndeje apo oda burrash, ate e ftonin në polici, duke e malltre tuar se çka dashtë të thotë me sintagmën:”Populli i din të gjitha dhe populli do t'i rregu llojë punët, dhe: -Të mëdhenjtë na kanë

dëmtuar! -Duke aluduar në Konferencën famëke qe të Londrës, pra për coptimin e trojeve shqiptare, shkëputjen nga trangu amë.

Nëntëmuaj rresht vijuan hetimet ndër më të tmerrshmet, duke ia lëshuar pikat e ujit, nga maja e kokës deri tek thembrat e këmbëve, më rrëfente ai me gojë të vetë. Pas hetimeve nga më shtazaraket,ate e dënuan me 13 vjet burgim drakonian në ishullin famkeq - Goli Otok. Më kujtohet një rast kur ishte në ndeje tek ne, iu drejtua babit tim e i tha: Mua Arif, për një fjalë goje që e thoja, më thërrisnin në polici pa fijen e fajit, ndërsa, jemi dëshmitarë, e kemi dëgjuar të gjithë se ç'thotë Ejup Grazhdani, në mes të tregut, ai brohorit: - Dita e betërit! Ka ardhur dita e myflizit! Që në kuptimin figurativ simbolizon ardhjen e një Sistemi diktatorial e të korruptuar. -Mandej reciton vargjet e Naimit: - Krujë o qytet i bekuar, prite – prite Skënderbenë, ka ardhur si pëllumb i shtruar, të shpëtojë Mëmëdhenë! -Të gjithë dibranët kënaqen kur e dëgjojnë. Për çudi, thonte Xha Nuzi, atij s'ia marrin për të madhe, sepse shtihet se është sharllatan, por jo ai është tepër i zgjuar dhe din se ç'vepron...I lumtë!

Filxhani prej fajance i Mixhës Nuz

- Pas vuajtjes së dënimit në burgun famë keq të Goli Otokut, ai doli i sëmurë nga tuberkullozi. Sa herë që vinte tek ne për vizitë, nënës sime të ndjerë ia kërkonte filxhanin e veçantë e të vetin të kafes, jo vetëm kur vin te në shtëpinë tonë, por kudo që shkonte, ai ishte i vemendshëm dhe s'deshte që të tjerët infektohen nga ajo sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme gjatë atyre viteve.

Në çdo odë, ndeje e konaqe, jo vetëm të moshuarit, por edhe të rinjtë edhe ëmijët, me vemendje te posaçme i dëgjonin fjalët e tij, mendimet e tij dhe këshillat e tij, të cilat simbolizonin filozofinë dhe tërë mendjemprehtësinë populllore të Trevës historike të qytetit të Dibrës së Madhe me rrethinë.

Ai i jepte rëndësi punës kolektive e jo asaj individuale dhe thonte: -Një mende, asnjë mende, dy mende përbëjnë një gjysëm mende, ndërsa tre e më shumë mende përbëjnë një mende”. Që do të thotë se shqiptarët lypset të punojnë bashkarisht si kolektivitet e jo individualisht. Nga Mixha Jonuz dhe nga disa pleqë, poashtu të mençur dibran, të ndjerët: -Ramiz Begu e Eqrem Begu- ishministër i Finansave në kohën e A. Zogut, Demir Marku dhe Shyqri Disha i grumbullova të dhënat rreth temës: “Legjenda e Urës së Spiles” e cila në formën e gjysëmharkut ndërtuar nga fundi i shek. XVIII, duke i lidhur dy brigjet e lumit-Drin i Zi, në hyrje të Dibrës së Madhe. Atë temë, në v.1965, Dr.Petro Janura më ngarkoi ta përgatis si punimseminarik. Andaj,që të pestëve ua diji për nder për të dhënat e sakta që m'i ofruan,

Sa herë që ktheja nga Kaçaniku në Dibër, ai dhe atdhetari Eqrem Begu, më dilnin përpara e më pyesnin për Kryetarin e Kaçanikut-Sali Bajra:-Si e kemi atë Pejgamberin (Engjëllin) tonë?!-Mirë është dhe, jua përcjellë të falat më të përzemërta prej tij. Ai gjithmonë vinte nga fshati Spas (Shpëtim) në Dibër, e blente gazetën e për ditshme “Rilindja” në gjuhën shqipe, ofrohej pranë ne të rinjve e na këshillonte haptazi: “Mësoni, mësoni dhe vetëm mësoni!
-Duajeni Atdhenë dhe Kosovën, flijoni diç për to”! Një ditë, duke kthyer nga komuna, ne, një grup të rinj, i dolëm përpara dhe e pyetëm:Ku ishe Mixha Nuz?Ai me buzëqeshje na u përgjegji: Në komunë.

Mandej, na parshtrroi pyetjen: - Më thoni pse i thonë komunë?- Asnjëri prej nesh s'dinim si t'i përgjigjemi. Atëherë, ai vazhdoi: - Domethënia e fjalës ko munë ka këtë kuptim: “Ku mundet, ku s'mundet, ku të sosin punë, ku s'të mbarojnë pu në”! -Pra, kështu është puna me nëpunësit nëpër të gjitha komunat e këtij pushteti. Ryshfeti bën punë-ryshfeti!
Pa ryshfet nuk të kryejnë punë! -Tha ai. Shpesh herë vinte tek ne, në familjen time në ndeje, sepse ate e kisha Nunin tim. Gjatë bisedës me babain tim, poashtu të ndjerë, i thon-te: -”Arif, ne pleqët s'dijmë gjë, të rinjtë dijnë më tepër”. Atëherë, unë ndërhyrja dhe i përgjigjesha:-Jo, Mixha Nuz, s'është e vërtetë, ju pleqët keni grisur më shumë këmisha (keni më tepër përvojë) dhe, dini më shumë se ne. Mirë po, ai qëndronte i palëkundur në mendimin e tij dhe thonte:

“Nëqoftë se ne pleqtë mendojmë se mund të bëjmë diç pa Rininë, gabojmë, por edhe nëse mendojmë se të rinjtë s'mund të bëjnë pa ne, gabojmë dhe më rëndë, sepse Rinia e din rrugën e vet”. Më vonë, thëniet e tij u bënë realitet. Më 11 mars '81, Rinia qe ajo, që i nisi demonstratat dhe kryengritjen gjithpopullore në Kosovë. Rinia qe ajo, që u flijua, u bur gos dhe masakrua vetëm se kërkoi liri dhe barazi në IRJM e në Kosovën Lindore, kurse Pavarësi për popullin e Kosovës.

Mendjemprehtë, vigjilent, gjakftohtë dhe i qetë

Me rastin e vdekjes së një fshatari në fshatin Bomovë, shkuaam së bashku me arsimtarin, Kadri Dema, për ngushëllime. Si zakonisht nëpër odat e fshatrave dibrane filitet me temsil (frazologjizma) dhe, poqe se ndodhën ndonjë i huaj apo i jashtëm, vësh tirë e kanë të kuptojnë domethënien e bisedës. Njëri nga fshatrët filloi ta thumbojë me fjalë Mixhën Nuz, i cili kishte përvojë të madhe dhe e jepte përgjigjen shpejt e me me logjikë, iu drejtua A. M. me këto fjalë: Unë Adem, nuk zemrohëm për ate që thua.E kam bërë shprehje që, sa herë që shkoj diku në ndeje apo në mixhli, marrë me veti një torbë dhe, fjalët që m'i thua Ty, i hudhi prapa shpine në torbë, ndërsa, fjalët e mira dhe me përmbajtje, siç folën: Ismet Marku, Kadri Dema dhe I.Egriu i fus në xhep, sepse:”Kur kuvendon me njerëz miq të mirë e të matur, të duket vetja dy herë më i zgjuar”. Mandej, thuhet: “Zemrimi e vë në provë të urtin, luf ta e njëj trimin, ndërsa nevoja mikun”.Ai që më lajkaton është armiku im, ai që më tregon drejt gabimet e mia është mësuesi im, ndërsa ai që më vë në dukje vepimet e mia të drejta është mik i im. Nuk i adhuroj lajkat,u përgjegji ai, me buzëqeshje dhe gjakftohtësi.

Përfundim:-Kohën e fundit, pak para vdekjes, Mixha Nuz lëngoi nga një sëmundje e rëndë dhe humbi intuitën. Sa herë që shkonim në vizitë, së bashku me babain tim, ai nuk na njihte më. Nuk zgjati shumë kohë dhe, më 1979, u nda nga më të afërmit dhe nga populli i tij i dashur, i okupuar e i coptuar në pesë shtete, që e deshte me shpirt dhe që sakrifikoi aq shumë.

Me pietet e krenari, këtë patriot e luftëtar për liri, të burgosur politik dhe filozofi popullor i Trevës së Dibrës me rrethinë, e përkujtojnë më të afërmit, miqtë dhe gjithë shqiptarët, sepse ai i takonte tërë Shqipërisë, Kosovës dhe trojeve të tjera iliriane.

Shumë këshilla e shumë ide i thitha prej tij.

Dritë i bëftë shpirti dhe lavdi veprës së tij !

“Një jetë në botën e letrave”

Figura e intelektualit në vështrimin qytetar

Nga FLORIKA BUSHI*

Është e vështirë të shkruash për figura të tilla të letrave shqipe, pasi hapësirat gazetareske janë të përmasave të vogla. Do të përpigemi të flasim sa më shkurt për një personalitet të tillë, ndonëse pamja e jashtme nuk ta jep këtë përshtypje, pasi për çudi në një trup aq të vogël, qëndron një mendje aq e madhe. E kemi fjalën për birin e Lurës, prof. Shaban Sinanin. Sa e gjerë është bibliografia e letrave të tij, aq e madhe është figura njerëzore e këtij punëtori të palodhur të kërkimit shkencor.

Prof. Shaban Sinani lindi dhe u rrit në Lurën me një bukuri të rrallë natyrore, në krahinën më të bukur të Shqipërisë. Mësimet e para i mori në vendlindje dhe më pas rreth viteve '83 u diplomua në fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në degën e gjuhësisë dhe të letërsisë shqipe. Te studenti dhe intelektual i ardhshëm spikati serioziteti dhe këmbëngulja për përvetësimin e dijeve. Përkushtimi dhe pasioni për të renë bënë që ai të binte në sy për mendimet e pjekura dhe mënyrën e gjykitimit, veçori këto që do ta shoqërojnë gjatë jetës së tij në punën e përditshme. Si bir i një familjeje të thjeshtë, djallë i një minatori të ndershëm, ai trashëgoi prej familjes edukatën e punës dhe mënyrën korrekte të sjelljes me njerëzit. Në morinë e punëve të tij, te prof. Shabani takon njeriun e thjeshtë dhe studiuesin e talentuar, gazetarin e politologun serioz dhe kritikun korrekt e së fundi, bashkëshortin ideal dhe babanë e dhembshur të dy vajzave të zgjuara e të edukuara, të cilat kurrësi nuk mund të jenë ndryshe prej prindërve të tyre.

Do të dëshiroja të zgjatesha më tej për jetën vetjake të këtij njeriu të thjeshtë dhe shumë dashamirës me kolegët, të cilëve kurrë nuk ua kursen ndihmën. Shumë mirënjohës besoj do t'i jenë të gjithë ata bashkëpunëtorë që nuk reshten së kërkuari ndihmën e tij, të cilët gjejnë te Shabani sigurinë për botimin e veprës së tyre, pasi kurrë nuk i refuzon. Dikujt një parathënie, dikujt tjetër një gjykim për veprën e vet, dikujt tjetër i sugjeron metodën dhe mënyrën e hartimit të një teme masteri a doktorature. Dhe të gjitha këto i bën pa u mërzhitur, duke u dhuruar të gjithëve pjesë prej kohës së tij shumë të çmueshme. Paanësia e gjykitimit, që pasqyrohet qartë edhe në veprën e tij e ka bërë mik me shumë personalitetet të njohura, pavarësisht se këta të fundit shpesh herë mund të kenë pasur kontradikta midis tyre (debati Qose – Kadare).

Një bibliografi e një spektri të gjerë që pasqyron jo vetëm profesionistin në fushë të gazetarisë, por edhe shumë studime të folkloristikës, në fushën e letërsisë e arkivistikës na japin njohuri më të madhe për aktivitetin shkencor të prof. Shaban Sinanit. Ai është autor i një numri të madh botimesh shkencore, artikujsh të botuar në shtypin periodik të kohës: është një pjesë-marrës në të gjitha aktivitetet shkencore dhe kulturore brenda dhe jashtë vendit, në të cilat dalton për kumtesat dhe ligjëratat e ku takohen mendimtarë dhe studiuesi shkencor më i përparuar. E gjithë kjo punë u kurorëzua me marrjen e titullit doktor i shkencave në fushë të folklorit në vitin 1998 me monografinë “Mitologjia në eposin e kreshnikëve”. Për pjekurinë e mendimit shkencor që spikati në të gjitha studimet e bëra, Akademja e Shkencave të Shqipërisë i propozoi Komisionit të Lartë të Atestimit që Shaban Sinanit t'i jepet titulli “Profesor” (2003). Interesimi për veprën e profesor Sinanit është aq i gjerë saqë shumë prej tyre i kanë kapërcyer edhe kufijtë e vendit tonë. Ato tashmë janë përkthyer jo vetëm në gjuhë të huaj, por janë pasqyruar edhe në faqet virtuale të internetit nga dashamirësit e tij të shumtë. Si një autor që gëzon një receptim të gjerë, shumë prej artikujve dhe veprave të tij i gjejmë të botuara edhe nëpër revistat më serioze dhe më prestigjioze të botës së jashtme të qytetërimit. Ndër veprat më kryesore mund të përmendim: “Pengu i moskuptimit”, studime letrare (1997); “Sipërore”, studime

letrare (1998); “Kosova në gjeopolitikë”, politologji (1999); “Mitologji në eposin e kreshnikëve”, studim monografik (2000); “Ura dhe kështjella”, studime etnologjike (2006).

Pasioni i tij për arkivistikën spikati gjatë kohës që ishte në drejtimin e një prej institucioneve me të rëndësishme të Shqipërisë, Arkivit Qendror të Shtetit. Natyra e tij qëmtuese, bëri që me dashurinë dhe përkushtimin e tij, t'u fshijë pluhurin e kohës shumë prej dokumenteve që kanë qenë dhe janë pjesë e pandashme e historisë së secilit prej nesh. Ai i dha jetë dhe dritë një prej botimeve me të vlefshme: “*Beratinus*” (2004), një përshkrim i kodikëve të Shqipërisë, që gjenden në AQSH, i cili, veç të tjerash, nëpërmjet dokumenteve arkivore, përshkruan “ringjalljen” e dy kodikëve më të hershëm të Beratit (“*Beratinus 1 dhe 2*”), njëri prej të cilëve është “*Kodiku i purpurt i Beratit*”, një nga variantet më të vjetra të Testamentit të Ri e një prej shtatë kodikëve të purpurt në shkallë botërore. Gjithashtu, me seriozitetin që e karakterizon në punën e tij të përditshme, ua lehtësoi mjaft punën bashkëqytetarëve të vet duke udhëhequr të gjithë procesin për katalogizimin e fondeve arkivore.

Botimi i tij më i fundit është përmbledhja me artikuj “*Një Shqipëri ndryshe*”, Tiranë, 2007, 405 f

Kjo vepër është një përmbledhje me artikuj të ndryshëm, të cilët për nga larmia e temave përfshijnë një hark të gjerë kohor, duke filluar që nga mesi i shekullit XX e deri në ditët e sotme. Shumëllojshmëria e tematikave, dukurive dhe gjithë zhvillimeve që pati Shqipëria në periudhën së cilës i janë kushtuar këto shkrime, e përligjin plotësisht titullin e librit. Shumica e shkrimeve janë intervista të botuara më parë në shtypin e kohës, të cilat i kanë dhënë autorit mundësi dhe hapësira më të mëdha për t'u shprehur.

Tematika e zgjedhur prej tij e ka pikënisjen në brezin e 1968-ës, te dilemat dhe dyshimet e shumta, të cilat e kanë ngacmuar vetë atë dhe që janë pak ose aspak të njohura prej brezave të sotëm. Ai është përpjekur që në fokusin e interesimeve të tij, nëpërmjet hulumtimeve të dokumenteve, të përfshijë të gjitha ngjarjet e ndodhura në këtë messhekull dhe të shpjegojë shkaqet përse ndodhën këto dhe njëherazi, shpjegon përse e kanë tërhequr vëmendjen e tij, si publicist dhe studiues. Në këtë botim gjejmë një nga arsyetimet dhe një nga pyetjet: “*A ka pasur një brez të vitit 1968*” në kohën kur bota ishte përfshirë në një luftë të pasqypal-lur, e cila u quajt “Lufta e ftohtë”? Çfarë ndodhte në Shqipërinë e asaj kohe të izoluar, ku siç thotë edhe vetë autori “*as zog u nuk mund të hynte*”? Përse brezi i vitit 68 u orientua për nga lufta kundër fesë, dhe kundër institucioneve klerikale? Shumë prej këtyre pyetjeve u jepet përgjigje që në fillim të veprës, e cila nën titullin që mbart shërben si një prolog dhe lidh lexuesin me të gjitha ngjarjet më të rëndësishme që përfshihen në çështjet që do të paraqesim më tej.

Vepra përfshin 46 shkrime dhe zbulon materiale të reja, bëma dhe fakte që kanë ngacmuar shumë intelektualë të asaj kohe. Shumë prej tyre, u përpoqën ta pasqyronin revolucionin e botës moderne edhe në Shqipëri, madje u treguan më të guximshëm sesa duhej dhe për këtë paguan edhe me jetët e tyre.

Pikërisht për këto dukuri bëhet fjalë edhe në shkrimet “*Festivali i 11-të- Ngjarje e dënuar ku ndahen e bashkohen dy periudha të këngës shqiptare*” (f. 13-27), ku autori thekson se Festivali i 11-të u ndëshkua jo për shkaqe që kishin të bënin me anën artistike të tij, por për nevoja politike. Shkrimin “*Festivali i 11-të – Një trokitje e butë e brezit të kit-arave*” është një intervistë që autori e ka dhënë vetëm për gazetën “Republika”, në maj të 2002. Ky shkrim vjen si një vazhdim i shpjegimeve të shkrimit të parë, çka vihet re edhe prej pyetjeve që i drejton intervistuesi : *Si ta kuptojmë thënien tuaj për një dënim “për nevojë*

politike”? Po e lëmë të hapur përgjigjen, me dëshirën e mirë për të ngacmuar kureshtjen e lexuesit, për ta nxitur atë që ta lexojë sa më shpejt këtë përmbledhje. Në këto shkrime, autori bën herë-herë ilustrime me copëza bisedash të shkëputura prej dokumentesh origjinale. Prandaj, duam të vëmë në dukje se është meritë që të botosh një vepër të tillë duke dhënë një mendim të paanshëm dhe duke theksuar sesa të rëndësishme janë arkivat për një popull, çka autori e sqaron fare mirë në shkrimet “*Në arkiva gjithnjë kanë qenë bashkë “armi*” e “*udhëheqës*” (35-40); “*Njohja dhe botimi i një dokumenti nuk janë e njëjta gjë*” (69-72); “*Informacioni rrezikohet nga “arkivat paralele*” (73-80); “*Burimet kineze për Shqipërinë ende nuk janë prekur nga askush*” (65-68); “*Ata që historia i ka bashkuar, arkivat duhet t'i bashkojnë*” (319-332) etj. Të gjitha çështjet kryesore që shqetësojnë mesin e shekullit XX, të cilat autori i ka si objekt të vëzhgimeve të veta, trajtohen këto edhe si çështje të identitetit kombëtar e shoqëror dhe njëherazi ai përpigjet t'i argumentojë, duke nxjerrë përfundimet përkatese për çdo shkrim. Të tilla janë shkrimet : “*Identiteti shqiptar është mbi çdo përbërëse fetare*” (131-140); “*Eurokultura dhe identiteti evropian i shqiptarëve*” (151-156); “*Një “Shqipëri evropiane” fle në botën e qytetëruar* (162-167); “*Një pasaportë evropiane për Shqipërinë*” (f. 189-188); “*Një slogan i ri për atdheun nga Nënë Tereza*” (333-339); “*Të dhëna për atdheun e Nënë Terezës*” (f. 340-346).

Ndërsa shkrimet e tilla si “*Beratinus*” dhe *shkolla e vendasve e shkruessve dhe scriptorium-eve* “ (168-168); “*Dorëshkrimi me shenjë e së përkryerjes hyjnore F*” (185-188); “*Kodiku i purpurt i Beratit* “ (200-205); “*Illyricum sacrum*” po “ mërgon” flasin qartë se Shaban Sinani është jo vetëm një njohës shumë i mirë i dokumentit, por edhe një interpretues shumë i saktë i tyre. Duke i bërë këto dorëshkrime të lexueshme, ai u ka dhuruar shqiptarëve shumë shkrime që vijnë prej thellësisë së kohërave shumë të largëta.

Një vend të rëndësishëm zënë edhe dokumentet që zbulojnë mjaft prej çështjeve historike. Kështu, mund të përmendim: “*Miti i Gjergj Kastriotit është mit i Rilindjes Europiane*” (f. 206-213); “*Gjergj Kastrioti –figurë e Rilindjes Europiane*” (f. 214-230); “*Konferenca e Ambasadorëve*” (f. 347-354); “*Në Shqipëri arma që qëllloi mbi Duçen*” (f. 366-383); “*Antifashizmi në Shqipëri*”(f. 384-393). “*Kështjella e virtytit*” (394-399) është shkrimi i fundit që mbyll vëllimin. Mendojmë se është me interes për fushat e albanologjisë. Ai është i shkruar sipas tregimit të prof. Aleks Budës, mbështetur në ngjarje të jetuara, kushtuar albanologut hungarez Ferenc Nopça.

Mjaft interesante janë edhe shkrimet që flasin për çështjen e hebrejve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, shkrimi “*Fono-dokumenti në Shqipëri*” (41-48) dhe shumë shkrime të tjera, të cilat lexuesit do kenë rastin t'i gjejnë në këtë përmbledhje.

Duke iu referuar titujve, kemi bërë një grupim “të vogël” për lehtësi gjykimi, por përmbajtja e shkrimeve, për nga problemet që trajtojnë, nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin. Secili prej tyre ka një objekt të vetin në këndvështrimin dhe gjykimin e autorit.

E pamë të arsyeshme të veçojmë dy prej shkrimeve më kryesore të kësaj përmbledhjeje: “*Ata që historia i ka bashkuar, arkivat duhet t'i afrojnë*”. Shkrimi është një intervistë që i është dhënë një reviste turke, “Haci Bektas Veli Arastirma Dergisi”, 2005, në të cilën autori flet për rëndësinë e Arkivave të Shqipërisë në krahasim me arkiva të tjerë të rajonit e të botës. Arkivat Shqiptare kanë një pasuri arkivore origjinale të jashtëzakonshme, që fillon prej shekullit të 6-të. Autori thekson, gjithashtu, se deri para një shekulli në Shqipëri ka pasur do-



kumente origjinale edhe më të hershme. Ai përmend ndër shkrimet e vjetra një dorëshkrim të shekullit të katërt, gjetur në Berat, më 1868 prej një studiuesi belg, si dhe dy dorëshkrime të tjera të vjetra në Gjirokastrë, njëri i shekullit të katërt dhe tjetri i shekullit të parë. Kjo periudhë prej 15- shekujsh është një pasuri e madhe arkivore. “Kultura e ruajtjes është shenjë qytetërimi. Vlerat ruhen atje ku ka klimë të shëndetshme për to.”- vën në dukje autori, duke dashur ta vërë theksin jo vetëm te rëndësia që zënë Arkivat Shqiptare në rajon e më gjerë, por duke treguar se është pikërisht kjo, që tregon se në botën shqiptare ka pasur një traditë të hershme për ruajtjen e dokumentit. Dhe pikërisht është kjo traditë që ka bërë të mundur të ruhen këtu tek ne vlera shumë të hershme, që nga grekët e lashtë, dokumente të gjuhës latine, në osmanishte, në persisht e arabisht, në italisht e frëngjisht. Kjo tregon më së miri se ruajtja e kësaj pasurie arkivore në AQSH është një prej treguesve që dëshmon edhe sesa e hapur ka qenë kultura shqiptare për të gjitha kulturat e tjera.

Në lidhje me nismat që janë marrë në këtë institucion, autori ndalet veçanërisht në punën që është bërë me dokumentin konkretisht, duke i bërë më të njohura për botën dhe përmend si më të rëndësishmet regjistrimin në një nga programet e Unesco-s, “*Memoire du Monde*”- “*Kujtesa e Botës*”, i cili është programi më i rëndësishëm i kësaj Organizate ndërkombëtare të ngarkuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të njerëzimit. Ai shprehet, gjithashtu se janë rreth 100 studiues nga bota që kërkojnë të bëjnë kërkime në fondet e arkivave shqiptare. Përveç botimit të kodikëve, të cilët i përmendim më lart, si mjaft të rëndësishëm ai përmend edhe bashkëpunimin me universitetin “Gazi” të Turqisë, me grupin e punës të të cilit u arrit të përgatitej katalogu trigjuhësh dhe i ilustruar, “Dorëshkrime osmane në AQSH”, ku janë bërë të njohura afro 500 dorëshkrime që ruhen në Arkivat e Shqipërisë. Disa prej projekteve që presin bashkëpunimin e ndërsjellët janë: “Ibrahim Temo dhe lëvizja “Bashkim e Përpamin”- përmbledhje dokumentesh; “Sixhiliti i sherijes së Beratit- një enciklopedi të dhënash” etj. Përveç kësaj që nga janari i 2005, autori thekson se një interesim shumë i madh është kërkuar prej administratës së TIKa-s në Tiranë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi të dyanshëm do të bëhet i mundur botimi i katalogut “Fermanët sulltanorë për Shqipërinë dhe shqiptarët”, një vepër ku paraqitet inventari i plotë i këtyre akteve perandorake që ruhen në arkivat shqiptare, inventar mbi 600 tituj. Çështje të tjera të trajtuara në këtë shkrim janë: Rëndësia e AQSh nga pikëpamja e historisë osmane; Si mund t'i bëjmë të përdorshme dorëshkrimet mbi bektashizmin; Çfarë rëndësie kanë për Shqipërinë arkivat shtetërore të Republikës së Turqisë? Cili do të jetë kontributi i këtyre arkivave për të ndriçuar historinë e Shqipërisë. Të gjitha këtyre çështjeve autori u jep shpjegimet e duhura.

“*Ka dhe një dosje për Kadarenë*” pranë *jurisë së “The Booker Prize Foundation” (103-108)* si dhe shkrimet “*Kritikat e fshehta*” të mbeten të fshehta! (94-102); “*Nuk do të hesht përpara të vërtetave të reja*”(109-121).

(Vijon në faqen 11)



Nga Akademik prof. dr. Jani THOMAI

Ç'PËRBËN AKADEMIJA E SHKENCAVE NË SISTEMIN E PËRGJITHSHËM TË KËRKIMIT SHKENCOR?

Në "Fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë", nr. 146, dhjetor 2006, është botuar një ligj, më i fundit, "Ligji nr. 9655, datë 11. 12. 2006, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", në nenin 1 të të cilit thuhet: "Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë (në vazhdim Akademia) është institucion shkencor, që vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh".

Akademia e Shkencave është organi më i lartë i kërkimit shkencor në shkallë vendi, prandaj edhe quhet "Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë". Ajo bashkon si anëtarë të vet shkencëtarët më të shquar të vendit, është institucion autonom, që udhëhiqet nga kërkimi i të vërtetave shkencore dhe funksionon sipas një statuti të miratuar nga Asambleja. Akademia kryen kërkime e studime shkencore teorike e zbatuese në fushat e shkencave shoqërore albanologjike, natyrore e teknike, të cilat vihen në shërbim të shoqërisë, të shtetit dhe të interesave kombëtare.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë është themeluar në vitin 1972 (më 10 tetor), duke përfshirë disa institute e qendra të asaj kohe (Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Institutin e Historisë, Institutin e Kulturës Popullore, Qendrën e Kërkimeve Arkeologjike etj.) dhe duke shënuar kështu një hap të madh përpara në rrugën e zhvillimit të kërkimit shkencor në Shqipëri. Fjalën përruese të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e mbajti gjuhëtar i shquar, akad. Eqrem Çabej; kryetari i saj i parë ka qenë historiani i shquar, akad. Aleks Buda. Ky vit që jemi, 2007, mund të quhet vit jubilar i themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, por edhe vit i reformimit të saj të thellë.

Ngritja e Akademisë së Shkencave u dha një vullt të ri kërkimeve e studimeve shkencore në ato fusha, tashmë nën një organizim e udhëheqje shkencore të specializuar. Veprat themelore të hartuara nga Akademia e Shkencave në fushat e gjuhësisë, të historisë së letërsisë, të historisë së Shqipërisë, të folklorit, të arkeologjisë, të shkencave të natyrës etj. ushqyen edhe përmbytjen e lëndëve në shkollat e larta dhe rritën cilësinë e tyre. Por Akademia e Shkencave ishte edhe shprehje e një zhvillimi e përparimi të vendit në përgjithësi dhe përbënte një simbol nderi për Shqipërinë.

Sot, pas 35 vjetësh dhe para mundësisë së zbatimit të reformës, Akademia jonë e Shkencave ka 29 akademikë dhe 13 institute e qendra të kërkimit shkencor, të ndarë në dy seksione: Seksioni i Shkencave Shoqërore Albanologjike dhe Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike. Në Seksionin e Shkencave Shoqërore Albanologjike përfshihen Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti i Historisë, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Qendra e Studimit të Arteve dhe Instituti i Ekonomisë.

Ç'KA ARRITUR E Ç'PO TRAJTON SOT AKADEMIJA E SHKENCAVE?

Është e pamundur të përmenden, qoftë edhe përmbledhtas, arritjet e Akademisë së Shkencave në këta 35 vjet dhe punët që janë nëpër duar. Vetëm në fushën e shkencave shoqërore janë botuar qindra mijë faqe për gjuhësi, histori letërsie, histori, arkeologji, kulturë popullore, histori arti etj., vepra madhore si "Gramatika e gjuhës shqipe", "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", "Studime etimologjike në fushë të shqipes" (në 8 vëllime, E. Çabej), "Fjalor enciklopedik shqiptar", "Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe" (në 2 vëllime), "Historia e letërsisë shqipe", "Historia e popullit shqiptar" (2 vëllime), "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", "Illirët", "Shqipëria arkeologjike", "E vërteta mbi Kosovën", "Trashëgimia kulturore e popullit shqiptar", "Korpusi i folklorit gojor", "Korpusi i veshjeve popullore", "Arkeologjia shqiptare", "Fjalor enciklopedik i arteve", dhjetra fjalorë të tjerë shpjegues, sinonimikë, frazeologjikë, terminologjikë, qindra monografi e studime, dhjetra revista shkencore periodike (me 2-4 numra në vit) dhe përmbledhje seriale studimesh për leksikologji, për dialektologji, me dokumente e materiale etj., dhjetra konferenca e kongrese shkencore kombëtare e ndërkombëtare, shumë projekte shkencore me bashkëpunim edhe me organizma ndërkombëtarë etj. Kongreset, simpoziumet, konferencat e sesionet shkencore kombëtare e ndërkombëtare për gjuhësi, për histori, për arkeologji etj., si Kongresi i drejtshkrimit, konferenca për gjuhën letrare shqipe, konferenca për figura të shquara të letërsisë shqipe, konferencat për Skënderbeun, konferenca e kuvende për Ilirët dhe etnogjenezën e popullit shqiptar e shumë veprimtari të tilla të tjera janë të njohura botërisht. Po kështu, veprimtaritë në kuadër të AIESEE-së, të EURALEX-it e të shoqatave të tjera shkencore europiane e ndërkombëtare janë të shumta. Të panumërta janë ekspeditat kërkimore-shkencore leksikologjike, dialektologjike, folklorike, etnografike, arkeologjike (me gërmime e studime për paleolitin, mezolitin, neolitin, epokën e bronzit, epokën e hekurit, periudhën romake, mesjetën etj.), me zbulime e gjetje të një rëndësie shkencore e kombëtare të jashtëzakonshme) në gjithë trojet shqiptare, si edhe kërkimet arkivore e bibliografike brenda e jashtë vendit. Është puthuaj e pamatshme puna e bërë për krijimin e pasurimin e fondeve arkivore gjuhësore (kartekat), historike, folklorike, arkeologjike (objektet) etj., një pasuri shumë e çmueshme për tashti e për të ardhmen e shkencave shqiptare. Akademia e Shkencave ka botuar rregullisht një vjetar ku pasqyrohet gjithë puna vjetore e saj. Po në sistemin e Akademisë u strukturuan institute e qendra të kërkimit e të studimit shkencor, u përpunuan metoda e u krijuan përvoja shkencore, u formuan breza studiuesish tashmë të njohur, u anëtarësuan institutet dhe vetë Akademia në forume, shoqata e komisione europiane e ndërkombëtare. Të gjitha këto janë vënë në shërbim jo vetëm të zhvillimit të të përparimit të shkencës, por edhe të arsimit në Shqipëri, sidomos të arsimit të lartë. Arritjet në fushat e shkencave albanologjike, me një shkallë të lartë origjinaliteti e objektiviteti, i shërbejnë ruajtjes së identitetit kombëtar dhe e shpërfaqin këtë para botës me vetëdijen e një populli të lashtë dhe të një kulture të admirueshme.

Sot po punohet gjithashtu mbi vepra madhore, si "Fjalori enciklopedik" e "Enciklopedia shqiptare", "Fjalori i gjuhës shqipe" i tipit të madh, me mbi 80 000 fjalë, në 5-6 vëllime, vëllimi III e i IV i "Historisë së popullit shqiptar", informatizimi i fondeve gjuhësore e disa vepra të tjera të serisë në fushën e arkeologjisë, të kulturës popullore, të arteve etj. Janë shumë vepra e veprimtari që kërkojnë më shumë studiues cilësorë, krahas forcimit të mëtejshëm të teknikave dhe përvetësimit e zbatimit me sukses të metodave bashkëkohore.

SI DO TË NDODHEJ AKADEMIJA E SHKENCAVE PARA LIGJIT PËR REFORMIMIN E SAJ?

Është e drejtë të bëhet kjo pyetje, meqë shprehja rrodhi deri këtu dhe tashmë mund ta përfytyrojmë zhvillimin e mëtejshëm para zbatimit të atij ligji, i cili, siç thamë, është shpallur në "Fletoren zyrtare". Natyrisht ai do të zbatohet si kërkesë e shtetit ndaj Akademisë, por dua të shtoj diçka lidhur me frymën e me diskutimet e bëra rreth kësaj reforme dhe rreth punës së Akademisë.

Ka kaluar më shumë se një vit që kur nisi të flitet për reformimin e kërkimit shkencor në Shqipëri e, në këtë kuadër, edhe për Akademinë tonë të Shkencave. Jo vetëm grupi i ekspertëve, i ngarkuar për të hartuar platformën e reformës, por edhe akademikë, profesorë, gazetarë e intelektualë të tjerë kanë shprehur mendimet në shtyp, në televizion e në mbledhje të posaçme se ç'vend zë Akademia dhe si duhet të zbatohet reforma në të. Si çdo diskutim i drejtë e objektiv, edhe ky për reformën në fushën e kërkimit shkencor ka nxjerrë vërejtje e mendime të frytshme se si të përmirësohet puna shkencore në sistemet e ndryshme të organizimit të saj, porse, për fat të keq, nga padija (a, mos o Zot, nga keqdashja), disa gjëra janë shtrembëruar dhe, duke humbur objektivitetin, është hedhur baltë mbi vlera të çmueshme të krijuara me aq mund e shpenzime për një kohë të gjatë. Këto vlera nuk janë "pronë private" e Akademisë së Shkencave, edhe pse janë krijuar prej saj, janë pronë e gjithë shoqërisë dhe e shtetit shqiptar. Kjo do të thotë që nuk mund të ndreqen punët mirë duke mohuar çka përbën arritje të shënuar e të dobishme. E duke dalë në mbrojtje të këtyre arritjeve, akademikët nuk kanë pasur ndonjë "konflikt interesi", siç është shprehur një gazetar, sikundër nuk kanë konflikt interesi qeveritë, ministritë, institucionet, shtetarët, politikanët e çdokush tjetër kur paraqesin e mbrojnë arritjet e veta dhe plotësimin e detyrimeve funksionale.

Ç'ka bërë Akademia e Shkencave? Kjo ka qenë ndër pyetjet më të para që është bërë prej akëkujt, duke vënë në dyshim punën disave çare

të Akademisë dhe me këtë vetë motivin e jetimit të saj. Kuptohet që pas kësaj pyetjeje kanë ardhur (zh)vlerësimet, se "Akademia ka qenë anemike", "ka harxhuar shumë e ka dhënë pak", madje për ekstremistët "puna e saj ka qenë zero". Për ata që vërtet nuk e kanë ditur se ç'ka bërë e ç'bën Akademia, u është këshilluar të lexojnë "Vjetarin" e Akademisë së Shkencave, ku, siç thamë, është dhënë çdo vit raporti për gjithë veprimtarinë e saj shkencore. Mirëpo ka pasur shkurse artikuajsh e kritikëdashës që nuk e njihin punën e Akademisë, as "Vjetarin" e saj nuk e lexonin, as e merrnin mundimin të shihnin ç'bënte Akademia e Shkencave dhe as hiqnin dorë nga mohimi i punës së saj. Kuji i shërbente kjo? Akademia e Shkencave ka qenë dhe është një institucion elitë jo thjesht si emër, por mbi të gjitha si vlerë. Mbi të dhënë e mësipërme dua të kujtoj këtu, nga fusha e shkencave shoqërore, emrat e akademikëve të nderuar Eqrem Çabej, Aleks Buda, Mahir Domi, Selman Riza, Dhimitër Shuteriqi, Stefanaq Pollo, Androkli Kostallari, Tish Daija, Bedri Dede etj., që fizikisht nuk janë më në këtë jetë, por mbeten krenari e përhershme e kombit tonë. Të flasësh për ta duhet njohur më parë ç'na kanë lënë trashëgim. Mund të shtoj që Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave, ku bëj pjesë edhe unë, ka sot 15 anëtarë akademikë: Dritëro Agolli, Hamit Beqja, Jorgo Bulo, Shaban Demiraj, Andromaqi Gjergji, Kristo Frashëri, Ismail Kadare. Hekuran Mara, Vladimir Misja, Luan Omari, Kristaq Prifti, Arben Puto, Alfred Uçi, Zija Xholi. Akademia e Shkencave ka edhe anëtarë të jashtëm e anëtarë nderi personalitete të shquara të botës shqiptare dhe personalitete të huaja që kanë dhënë kontribute të shënueshme për zhvillimin e pasurimin e shkencave të lidhura me Shqipërinë e me popullin shqiptar, si Alain Ducellier (Francë), Antonio La Pergola (Itali), Eric Hamp (SHBA), Ildirz Ajeti (Kosovë), Rexhep Qosja (Kosovë), Ferid Murati (SHBA), Rexhep Ismajli (Kosovë), Mark Krasniqi (Kosovë), Luan Starova (Maqedoni) etj. Pyetja "ç'kanë bërë a ç'bëjnë këta akademikë" do të ishte pa vend, sepse do të ishte e qortueshme edhe vetëm padituria për punën e tyre. Kështu mund të thuhet edhe për profesorët e bashkëpunëtorët e tjerë shkencorë në institutet e qendrat shkencore që deri më tash përfshiheshin në sistemin e Akademisë. Dhe ç'ndodh kur me ngulim, por padrejtësisht, kërkohet të motivohet ideja e ngurtësuar e zhvlerësimit të një vlere të sprovuar shkencore, siç bën një profesor e publicist i njohur, kritika këmbëngulëse e të cilit mund të rrahë ndoshta tjetërkund, por lidhje me reformën nuk ka. Ai i turrent "Fjalorit të shqipes së sotme" (2002) dhe për këtë të vjen çudi, sepse profesori nuk është fare i paditur në fushë të leksikografisë, vetë ai këtë fjalor e ka vënë përpara, mbi tryezë, sa herë ka bërë emisione televizive të mira për pastërtinë e gjuhës shqipe, e ka mbajtur si kuran, si ungjill a si kushtetutë, mbi të cilën është betuar. Mbase është një hollësi, por ka vlerë më të gjerë, prandaj, për ata që nuk e dinë të vërtetën, duhet të kujtojmë (dhe kjo është thënë shprehimisht në *Parathënie*) që "Fjalori..." i vitit 2002 nuk është fjalor i ri, është ribotim i "Fjalorit të shqipes së sotme" (1984), i cili, me vendim të drejtorisë së atëhershme të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, më 1994-1996 u rishikua "vetëm për pastrim ideologjik", por që grupi i rishikimit, në punë e sipër, bëri ndryshime edhe në listën e fjalëve (jo me "7-8 fjalë", siç thuhet, por me mbi 3000 fjalë, heqje e shtesa), në struktura kuptimore e në shpjegime, në karakterizimin e shumë fjalëve etj., të cilat nuk është e drejtë të mos përmenden. Pastaj, po nga ky grup pune, përveç veprimtarive shkencore (konferenca, simpoziume) dhe studimeve shkencore (monografi, artikuj, kumtesa, tekste universitare etj.), kanë dalë ndërkohë ose kohët e fundit edhe vepra të tjera leksikografike, si "Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe", "Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe", "Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe", "Fjalor i gjuhës shqipe" (me rreth 48 000 fjalë, me format të vogël "dore", të përshtatshëm edhe për nxënës e studentë) etj.; veç këtyre, ka filluar puna edhe për fjalorin e madh shpjegues të gjuhës shqipe (në disa vëllime). Nëse të pakënaqurit nuk i njohin këto vepra, kjo do të ishte një e keqe më e vogël se të tjerat, por gjithsesi ky është problemi i tyre. Ndërkaq do të ishte e natyrshme kërkesa për një fjalor tjetër më të vëllimshëm, më të përditësuar. Të më falin lexuesit që këtu nuk mund të jap shumë shembuj nga gjithë prodhimi shkencor i instituteve të shkencave shoqërore, vlera e të cilit jo vetëm për zhvillimin e shkencave albanologjike kombëtare, por edhe për arsimin e lartë e të mesëm, për kulturën, për pohimin e identitetit e të krenarisë kombëtare, siç u tha, janë të padyshimta, përveç atyre që nuk duan t'i shohin e t'i pranojnë. E them me siguri që mbetet jashtë fare pak pro-

dhim shkencor që nuk lidhet drejtpërdrejt me kërkesat e shkollës së lartë e të mesme (pa llogaritur punën e drejtpërdrejtë të punonjësve të këtyre instituteve në shkollën e lartë e në SHPU (Shkolla pasuniversitare) me leksione, seminare, udhëheqje shkencore, programe e tekste etj.). A janë këto të mjaftueshme? Natyrisht jo, sikundër nuk janë të mjaftueshëm njerëzit që merren me këto punë, mbështetja financiare, pajisjet teknike bashkëkohore, mundësitë e botimit e të qarkullimit etj.

ÇFARË DO TË DËSHIROHEJ E DO TË PRITEJ NGA NJË REFORME NË KËRKIMIN SHKENCOR?

Parimisht, si në fusha të tjera, edhe nga reforma në fushën e kërkimit shkencor, do të pritej përmirësim në të gjitha ato drejtime që shpëtojnë përpara kërkimin shkencor, në numrin e nevojshëm e në cilësinë e duhur të studiuesve, në teknikat bashkëkohore, në mbështetjen financiare, në format e organizimit të punës, në forcimin e autonomisë shkencore dhe të drejtimit shkencor etj., përmirësim që natyrshëm mendohet të sjellë prodhim shkencor më të madh, më cilësor (pra edhe më të dobishëm) dhe më ekonomik. Kemi menduar dhe mendojmë se kur udhëhiqesh nga ky parim i drejtë, nuk mund të paravendosësh pa e studiuar me themel gjendjen në çdo qelizë të punës shencore, nuk mund të vësh kusht të prerë, fjala vjen, që Akademia Shkencave të mos ketë në varësi asnjëherë asnjë institut a qendër studimi ose të mos ketë të drejtën për të ngritur të tillë pranë saj. Ky shndërrim sjell rrjedhime të vetvetishme e të padiskutueshme për Akademinë tonë, si shpëputja e instituteve prej saj dhe varësia e tyre prej një organizmi tjetër (universitet a ministri) e përsëri rrjedhimisht rrudhjen e tyre deri në departamente, që do të thotë shkurtim punonjësisë e shkrirje fushash studimi (kur shqetësimi kryesor sot është ardhja e kërkuesve të rinj të talentuar dhe përgatitja e ekeipeve më të mëdha studiuesish që të sigurohet vijimësia e kërkimit shkencor në këto fusha dhe specializimi i studimeve në nënfusha), sjell pakësim të mjeteve financiare (kur pranohet që sot Shqipëria e ka buxhetin për kërkimin shkencor shumë të ulët – 0.18% të GDP) e për pasojë të të gjithave ngushtim të mundësisë për punë shkencore më të gjerë e më cilësore. Nuk duket bindëse ideja se kërkimi shkencor do të jetë më mirë nëse institutet do të varen nga një organizëm administrativo-politik, pasi këto institute për kërkimin shencor nuk kanë aq nevojë për organizim e udhëheqje administrativo-politike, sesa për organizim e udhëheqje shkencore, siç mund ta bëjë Akademia e Shkencave. Dhe detyrat shkencore të këtyre instituteve nuk janë pakësuar e nuk janë lehtësuar, përkundrazi, në kohën e tanishme janë shtuar e janë bërë më të mprehta. Pastaj, një reformë, që ka si synim përmirësimin e kërkimit shkencor, parashikon jo vetëm rrudhje, ngushtim, shkurtim njerëzish e repartesh jo të frytshme a jo të kohës, por edhe ndryshime në drejtim të kundërt, pra zgjerim, plotësim e shtim në ato fusha kërkimi ku është e nevojshme. Një parashikim të tillë, që mund ta përfshinte e ta zgjidhte reforma për kërkimin shkencor, po e dëshmoj me një shembull nga fusha e gjuhësisë. Dihet që sot leksikografia (hartimi e botimi i fjalorëve) ka marrë kudo zhvillim të madh. Fjalorët e tipave të ndryshëm (njëgjuhësh e dygjuhësh, terminologjikë, frazeologjikë etj.) janë vepra shumë të kërkuara, jo thjesht si vepra shkencore me vlera teorike, por edhe si mjete pune me vlera praktike për shkollën e për prodhimin, për shkrimtarët, për publicistët e për përkthyesit, për shqiptarë e për të huaj etj. Kërkesat e gjera e të ditës, tirazhi i madh i botimit, shpeshësia e riprodhimit etj. e kanë kthyer sot leksikografinë thuajse në industri, me përfitime nxitëse e integruese në ekonominë e tregut. Prandaj në disa vende janë ngritur institute a qendra pjesërisht vetadministruese për hartimin e fjalorëve. Reforma jonë për kërkimin shkencor mund të parashikonte ngritjen e një instituti (ose së paku të një qendre) të veçantë për leksikografi, që të kishte disa departamente, si: 1. për fjalorët shpjegues kombëtarë; 2. për fjalorë të veçantë (krahinorë, shkollorë, të shkrimtarëve, të neologjizmave, të fjalëve të huaja, tematikë a ideografikë, inversë, sinonimikë, frazeologjikë etj.); 3. për fjalorë dygjuhësh e shumëgjuhësh; 4. për fjalorë terminologjikë; 5. për fjalorë elektronikë. Një institut a qendër e tillë do të mblihdte në gjirin e vet leksikigrafët më të kualifikuar e më me përvojë dhe me siguri do të rriste shumë numrin e fjalorëve të hartuar e të botuar, do të plotësonte spektrin e tipologjisë leksikografike sipas kërkesave të kohës (d.m.th. sipas asaj që *duhet* të bëjmë dhe jo sipas asaj që *mund* të bëjmë), por mbi të gjitha do të ngrinte shumë cilësinë shkencore të fjalorëve, po ashtu do ta bënte më pak të kushtueshme punën ►

Shuhet mjeshtri i skenës Sulejman Pitarka

Ndahet nga jeta në moshën 83-vjeçare një prej emrave të njohur të skenës shqiptare

Ai nuk qe vetëm aktori që fu teji i tëri brenda një roli, duke u komanduar nga fuqia e personazhit që regjisori i besoi, por dhe dramaturgu që me orë të tëra imagjinoi skenën dhe shfaqjet që ndërtoi më parë në mendjen e tij. Për të gjithë ata që e kanë parë të interpretojë në skenë, dhe ata që kanë shijuar një vepër të shkruar nga ai, ai do të mbetet njeriu me të cilin mund të karakterizohet teatri shqip i viteve të tëra me rrallë. I qetë, por tepër pasionant kur flitej për teatrin për rolet, apo evoluimin e tij. Një personazh nga ata që koha i sjell rrallë i mbushur vetëm me dashuri për profesionin. Për Sulejman Pitarkën, ashtu si për gjithë kastën e aktorëve të brezit të tij, të patjetërsueshëm nuk mund të flitet aq thjesht. Nuk mjaftojnë shfaqjet ku ai ka interpretuar apo bisedat që mund të kesh bërë me të për të rrëfyer jetën e këtij artisti të madh. Janë mijëra gjëra të cilat ai i mori me vete dje përgjithmonë, në orët e fundit në këtë jetë, të cilat besoi se ishin vetëm të tijat. Por ne do të mundohemi ta lexojmë atë çfarë ka ndodhur me të nëpërmjet roleve dhe pamjes së tij në vite, që na ofrohet nga kinematografia apo ato sekuenca që mëndja jonë ruan nga teatri.

Ajo çfarë kritika ka shënuar pas çdo shfaqjeje për të është mënyra krejt origjinale se si ai e jepte një rol. Për Pitarkën, në momentin kur mernte një rol për të vënë në skenë, ai nuk mendonte më si ai, por si personazhi, dhe ndoshta kjo ishte mënyra që ai kishte zgjedhur për të qenë sa më i vërtetë në skenë, duke folur me gjuhën e personazhit. Dramatik dhe i ndjeshëm, Pitarka do të ishte një nga emrat më potent të te-

atrit shqiptar këto vite, nga ata aktorë që të bënin të mendoje thellë kur e shihje pas çdo interpretimi. Interesant është të shohësh dhe shënimet që shikuesit e ndryshëm linin për të pas çdo shfaqjeje. “Ju më pëlqeni. Më pëlqeni pasi dini të më gënjeni me lezet”, i shkruante një lexues. Janë një mori thëniesh për të. Adhuresit e kinemasë dhe të teatrit dje janë trishtuar për humbjen e tij, për aktorin që i bënte të reflektonin gjatë sa herë u shfaqej në ekran, apo në skenën e një teatri. Humbja është ajo që na bën të reflektojmë më shumë për ato që nuk do t'i kemi më, për njerëz që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm vetëm nga dashuria, për njerëz që me pasionin e tyre gjithnjë të çudisnin.

JETA

Jeta e tij është pak a shumë një subjekt i ngjashëm me të gjithë atyre artistëve që shkelën të parët në skenën e Teatrit Popullor në atë kohë. Një histori që nuk e kushtëzoi më pas pasionin për artin, por e bëri më të madhe lidhjen me të. Pitarka lindi më 2 shkurt 1924 në Dibrën e Madhe. Shumë shpejt do t'i braktiste studimet për t'i ardhur në ndihmë të atit, pasi familja nuk ishte në gjendje të mirë ekonomike. Pak kohë më vonë, ai do të zhvendoset në qytetin e Durrësit, ku fillimisht nis të punojë si hamall. Jeta e tij ka një trajektore interesante. Tepër i mprehtë dhe inteligjent, Pitarka fillon punën si ndihmëslogaritar në një firmë të njohur italiane dhe më pas në Bankën e Durrësit, por pas Luftës së Dytë Botërore, ai i braktis financat për t'iu përkush-

tuar teatrit. Miqtë e tij të dikurshëm, do të shpreheshin kur e shihnin në teatër se ai kishte lindur për të qenë në skenë, duke kujtuar mënyrën e tij se si fliste apo perceptonte gjërat. Më vitin 1951, ai shkel në Teatrin Popullor të asaj kohe i ndihmuar nga aktori i madh, Mihal Popi. Kanë mbetur të paharruara për spektatorët kryeqytetas rolet e realizuara prej tij në skenën e këtij teatri në dramën “Trimi i mirë me shokë shumë”, “Syleshi”, “Orët e Kremlinit”, “Familja e peshkatarit”, “7 shalianët”, “Vajza nga fshati”, “Doktor Aleks”, “Epoka para gjyqit” etj.

Çuditërisht, Pitarka ka luajtur role dytësore deri në vitin 1964, ndërsa në vitin 1956, i frymëzuar nga kujtimet e fëmijërisë dhe nga përvoja e vështirë jetësore, shkruan një dramë të spikatur të dramaturgjisë shqiptare: “Familja e peshkatarit”, të cilën e pason me vepra të tjera.

Kësaj kohe i përkasin disa nga rolet e tij më të paharueshme në teatër, si në pjesët “Halili dhe Hajria”, “Borgjezi fisnik”, “Epoka para gjyqit”, “Vajza me flokë të thinjura”, “Prefekti”, “Karavidhet”, “Arturo Ui”, “Një nuse për Stasin” etj.

Pas suksesit në filmin “Debatik”, Sulejman Pitarka do të siguronte një karrierë të pasur edhe në kinematografi. Në fakt, ai e filloi me filmin “Furtuna” dhe pas “Debatiku” interpretoi edhe në “Horizonte të hapura”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Gjenerali Gramafoni”, “Pas gjumëve” etj. Roli i tij më i spikatur është ai i Zheleznovit, komandantit rus, në filmin “Ballë për Ballë”. Ky film ka marrë pjesë në Festivalin e Filmit në vitin 1981 dhe është shpallur fitues i këtij edicioni.



Të tjerë filma ku ai ka interpretuar janë: “Tinguj lufte” (1976), “Guna përmbi tela” (1977), “Rrethimi i vogël” (1986), “Vdekja e burrit” në vitin 1989 etj. Për kritikët, Pitarka mbetet një aktor i rrallë, një njeri me të cilin mund të komunikojë shumë lehtë gjatë një marrëdhënie pune. Pitarka do të kujtohet edhe nga studentët e tij, nga ata të cilëve u mësoi disa teori mbi artin e aktrimit. Skena nuk mund të posedohet nëse ti nuk e ndjen atë. Kjo ishte filozofia e Pitarkës, që i bëri mijëra njerëz të ndjeheshin keq, ndërsa mediati raportonin lajmin për vdekjen e tij. Por aktori do të kishit një periudhë shkëputjeje nga teatri prej njëzet vitesh, dhe do të rikthehej më 2005-së në pjesën “Pjata e drunjte”. Një rol që nuk ndryshoi shumë nga rolet që Pitarka ka sjellë në skenë. Në rolin e një babai në marrëdhënie me nusen e djalit, ai dha gjithë dramën e madhe

të brezit të tij, në mentalitetin mes brezave. Nën regjinë e Gëzim Kames, që bëri të mundur dhe rikthimin e Pitarkës pas kaq vitesh, ai dha ndoshta një nga rolet më të bukura këto vite në teatër. Trishtimi i tij në “Pjatën prej druri” vijon të mbetet një nga pamjet më të arritura në teatrin pas '90-tës. Vetë regjisori Kame do ta quante fat për të bashkëpunimin me këtë aktor, që, sipas tij, i dha suksesin e veprës. Sulejman Pitarka është fitues i disa çmimeve në teatër dhe kinematografi, mes tyre çmimin për Karrierën si edhe medaljen “Mjeshtër i Madh i Punës” dhe titullin “Artist i Popullit”. Dje, pushoi zemra e tij, ndërsa jeta e tij do të mbetet gjithnjë në historinë e teatrit dhe kinematografisë shqiptare, sa herë që do të na duhet të flasim për historinë tonë të artit, apo sa herë që duam të zgjedhim modele, të cilave do të donim t'u ngjanim.

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE

shkencore në këtë fushë. Dhe nuk është fjala për institut a për qendër me departamente të fryra, por me departamente me 3-4 leksikografë cilësorë, që mund të udhëheqin disa projekte shkencore. Një institucion i tillë do të mundte të ndiqte edhe veprimtarinë leksikografike në shkallë vendi, për ta nxitur e për ta ndihmuar, jo për ta kufizuar a për ta vënë nën kontroll. Kështu mund të veprohej edhe për një qendër dialektologjike, për kërkime dialektologjike dhe për atlase të përgjithshme e krahinore. Janë zgjidhje të provuara me sukses në disa vende europiane.

A e vlen të rimerren e të diskutohen tashti këto çështje?

Rimarrja e ridiskutimi rreth këtyre çështjeve sot, pasi ligji për riorganizimin e Akademisë ka marrë miratimin zyrtar të qeverisë e të Kuvendit dhe në bazë të tij kërkohet hartimi i statutit të ri të saj, mund të duken të vonuar, por, sipas shprehjes “kurrë mos thuj kurrë”, koha dhe vullneti i pamungueshëm mund të ndreqin diçka, qoftë edhe të pjesshme, që shërben për të mirë. Veç kësaj, ligji për Akademinë, që e përmendëm në fillim, ka disa nene që vijnë në kundërshtim me logjikën juridike ose e dëmtojnë rëndë punën shkencore. Kështu, që në nenin e parë Akademisë i hiqet e drejta të ketë në varësi të saj institute kërkimore-shkencore; pse, ç'të keqe ka? Me nenin 8 shkelet e drejta më elementare e njeriut, e drejta për të votuar. Aty thuhet: “Anëtarët e Akademisë, me kërkesë të tyre, mund të shtyjnë moshën e daljes në pen-

sion deri në 75 vjet. Pas kësaj moshe ata nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion drejtues, por mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë, pa të drejtë vote”. Pra, për arsye moshe këta akademikë nuk kanë të drejtë të votojnë për të zgjedhur kryetarin e tyre, edhe pse kanë të drejtë me Kushtetutë të zgjedhin deputetët e Kuvendit. Sipas këtij neni, meqë ligji ka hyrë në fuqi, ata nuk mund të votojnë as për miratimin e Statutit të ri të Akademisë, i cili sapo është hartuar. Meqë nga 29 akademikët e tanishëm, 17 (shumica) janë mbi 75 vjeç, as Statututi, e pastaj as zgjedhjet e drejtuesve të rinj të Akademisë nuk mund të votohen, sepse nuk formohet shumica e nevojshme e parashikuar në ligj. Ja një ngecje, një ngërc që krijohet nga vetë ligji. Ka edhe nene që janë mbartur nga ligji i vjetër, kur Akademia kishte në vartësi institute e qendra kërkimore-shkencore, si nenet për Këshillin Ekzekutiv, i cili në ligjin e ri është i papërligjur, sepse është i panevojshëm për Akademinë në statusin e ri të saj. Kjo do të thotë se ka vend (e mundësi) për të ndrequr në vetë ligjin e ri për Akademinë e Shkencave. Dhe ligjet njerëzit i bëjnë, por edhe i zhbëjnë kur janë të gabuara. Shembulli më i fundit është pezullimi më 11 prill i këtij ligji nga Gjykata Kushtetuese. Ky veprim kushtetues hap mundësinë që ligji i ri të ndreqë gjithë ato nene e shprehje që e dëmtojnë punën kërkimore-shkencore, në vend që t'i japin asaj një mbështetje e shtysë më të fuqishme përpara. ■

“Një jetë në botën e letrave”

(Vijon nga faqja 9)

Mendua më ndaleshim në këto shkrime, pasi ky botim ka ngjallur polemika të ashpra në kohën kur u botua.

Të gjitha këto shkrime kanë si objekt shqyrtimi dhe interpretimi dokumentet që mbartin brenda tyre historikun e qëndrimeve të udhëheqjes dhe të propagandës së asaj kohe ndaj shkrimtarit. Në shkrimin “Kritikat e fshehta” nuk kanë asnjë arsye të mbeten të tilla, autori e ngre zërin me revoltë ndaj të gjithë atyre që reagues ndaj veprës “Ka dhe një dosje për Kadarenë.....” dhe “Dosja K”, pasi nuk ka më arsye që këto dokumente të mos interpretohen dhe njëkohësisht të zbulohen të gjitha të vërtetat për shkrimtarin Kadare, i cili ka qenë aq i përgjuar këto kohët fundit, madje sulmi mund të jetë i stisur po prej atyre njerëzve, të cilët në kohët e kaluara e kanë sulmuar atë. Ndoshta hapja ndaj këtyre dokumenteve bart në vetvete edhe frikën se mos sot pas kaq shumë vjetësh ata identifikohen. Ai sjell dokumente, të cilat dëshmojnë për vlerësimin dhe çmimet që i janë dhënë shkrimtarit Kadare prej botës së qytetëruar. Njëherazi ai nëpërmjet paraqitjes së këtyre fakteve shuan edhe kureshjen e atyre, të cilët janë të interesuar të mësojnë për proceset e hapjes dhe të ndriçimit të pjesës

më të frikshme të së kaluarës. Ai thekson se ky hap nuk u bë në kohën e duhur në Shqipërinë e fillimviteve '90. Por njëkohësisht shpreh edhe keqardhjen dhe revoltën kundër denigrimit që i bëhet kësaj figure (me qëllim) prej grupeve të caktuara. Përsëri edhe sot që nuk ka më një kontroll mbi lirinë e mendimit dhe të shprehjes, përsëri vazhdojnë po ato mënyra të goditjes, të cilat sot janë edhe më të sofistikuara prej teknologjisë së informatikës. Ndërsa në botimin e dytë të **“Një dosje për Kadarenë”** autori sqaron se ky botim ndryshon në përmbajtje me të parin dhe sjell dokumente të reja, disa prej të cilave ishin të panjohura në kohën e botimit të parë. Në këto dokumente vërehen se sulmet më të ashpra shkrimtarit i janë bërë prej Lidhjes së Shkrimtarëve, prej kolegësh “solidarë”. Ja si shkruan ai: “A është vërtet një sëmundje bashkësie tek shqiptarët të jenë kundër vlerave që i përfaqësojnë ata në mjediset ndërkomëtare dhe u japin identitete në botë”?

Si epilog po përmendim vetëm titullin e shkrimit **“E vërteta është si një pasqyrë: ai që sheh njollën mundet t'i sulet asaj për ta thyer” (f. 81- 87)**, pa u ndalur në brendësinë e saj. Këtyrë postulat i është përmbajtur gjatë gjithë shkrimeve të veta të paraqitura në këtë për-

bledhje prof. Shaban Sinani, i cili është përpjekur të zgjojë prej gjumit letargjik shekullor, etapat e zhvillimit historik dhe shoqëror të kombit duke shfrytëzuar të gjitha burimet në AQSH.

Mendojmë se ky botim është një risi ku lexuesi do të gjejë jo vetëm zbulimin e shumë “sekreteve” të paditura për kohën në vitin 1968, duke na zbuluar shumë të fshehta, por njëkohësisht është edhe një vepër metodike, e cila na mëson jo vetëm sesi duhet të punojmë me dokumentin, por sa korrekt duhet të jemi në interpretim. Paraqitja me vërtetësi e një periudhe kaq të gjatë, ku është përpjekur t'i pasqyrojë të gjitha çështjet, me qëllimin e mirë që njohja e gabimeve të së shkuarës nuk duhet të na mërzisë apo të na frikësojë, por të na ndihmojë të mësojmë që prej pësimit të nxjerrim mësimin. Për nga struktura e ndërtimit vepra i përket zhanërit të publicistikës, çka nuk e ka penguar autorin të përfshijë një periudhë kohore kaq të gjatë, përkundrazi e ka ndihmuar të bëjë një analizë të hollësishme e të saktë të dukurive të së shkuarës. Ajo që të bie në sy gjatë gjithë leximit të kësaj vepre, është përgjegjësia qytetare që ka autori për të thënë vetëm të vërtetën.

FLORIKA BUSHI

Punonjëse shkencore pranë Institutit tv Gjuhës dhe Letërsisë

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Çdo lis ka rrënjën e vet



Nga NAIM PLAKU

Sa kishte dhënë shefak dita, Davë Pana, si zakonisht mbushte poshterkën me drithë dhe dilte te lama të ushqente pulat. Në atë sfond të mugët ku poshtë rrëshqiste Drini e më përtej putheshin nga drita e parë e diellit majat e Lanës, aty ku ngrihej trekat me tri frengji, kulla e moçme e Panës, kjo grua e veshur me xhupin rozë të gatuar me gajtanë të zi, me rizën të lidhur fitoz e me atë vështrim të butë dhe të ëmbël, i jepte këtij mëngjesi një kënaqësi të detyruar. Nga brenda kullës dëgjoj kollën e shpifur të Bimit, e cila do të thoshte që duhej lënë çdo punë e nën hijën e manit të shtrohej posticja e t'i servirej kafeja ne takeme bakri burrit, pa e ndezur çibukun.

Kështu u bë. Katundi filloj të zgjohej, tymi nisi të dilte nga oxhaqet. Dyert e kullave nisën të kërcasin. Nusët përveshen krahjetat dhe po fshinin kurtet dhe rrugët e sinoreve.

-Oj Xhedike!- i bëri zë Bimi gruas dhe ajo mjenjëherë u ndodh para tij. -Kur të shkojsh te Kroj i Mirë, lëshoja një fjalë në dollap Tufës. Thuaj të marrë kosën e të dalë këndeje, se kullosa asht rrit e po çel. Në

mera i kanë lëshue tre gurë të rëndë e nuk din cilin ta veje në poren e cilin ta rrokasë. Kaq-1

-Njitash, o fat! -2-dhe në çast filloj të përgatiste buljerën që mbante aty te bunari i kullës, e ngarkoj në shpinë dhe u nis për të kroi i mirë, aty matanë përroit ku buronte uji i butë për të larë rrobat e për të zier më shpejt groshën. Afroj buljerën të burimit e shkoj me vrap tek shtëpia e babës ku i la një për një fjalët e Bimit. Kur u kthye, Bimi as e pyeti fare, por vazhonte të thithte çibukun që nxirrte pa pra shtëlluga të zeza tymi e erë të rëndë duhani. E dinte që fjala kishte shkuar tek miku, siç ia kishte thënë goja.

Nuk vonoj dhe erdhi Tufë Gjini:

-A në derë brenda, a në derë jashtë? pyeti pa u ulur mirë Tufa. -Edhe në derë e brenda, edhe në derë jashtë-3

-Guri te muri e cuca te burri, o bashi i mikut.

-Edhe mani, si te plakët, qet do gjethe të verdha, o Tufë Gjini

-Qorri nuk pyetet ka të çon kjo udhë.

-Dy frengji të kullës janë tuajat, Tufe. Iu tremben një ditë zogjtë shqipës e morën ferrat. U mërzit e shkreta, se kujtoj të mbrapmen. Njëri prej zogjve, që kishte mbetur në një skutë

ferre po i thërriste nënës: "Nënë, moj nënë ma hiq këtë mjegullën që më ka rënë në syve, se nuk po të shoh!". Eh!

Vërtet një re lëvizti tutje perendimit dhe filluan të duken më mirë lulet e livadheve, Atje, mes qingjave si topa të vegjël bore, fakellonte kurmi i bëshëm i një vajze të re, që lodronte mes shtellungave të tyrit dhe rrezeve të diellit dhe hidhte vështrimin pa drojë nga dullaku i nuserisë. Tufa ngriti dalngadalë shkopin dhe sikur kërkonte diçka mes ferrave:

-I shof! I njof... Paçin besë e jetë!

-Je daja. Njëri duhet vënë brenda avllisë, se s'bën.

-S'ka më keq, se kur të vënë barrë të rëndë në shpinë e, as nuk e mban e as e heq.

-Pak unë e pak ti, o Tufë Gjini.

Kur ishte në siklet Tufa rrotullonte vend, nxirrte këmbën e djathtë dhe si e shtrinte pak e hidhte si djallë i ri mbi gjurin tjetër. Kështu bëri edhe tani:

-Shih këtu o Bim Pana! Zot shtëpie bëju vetëm në shtëpinë tënde! E kam amanet babe. Po e ngul kunjin në mullën time. Ngreu ti, të ulëm unë, s'bën. As rri ti të flas unë, s'bën. Mirë se erdha dhe mirë se të gjeta!-4

-Paç faqën e bardhë. Kur të vijë Krrashi, do të çoj fjalë të pimë kafën.

-Çdo lis ka rrënjën e vet, o Bim Pana!

Shënim: Në këtë tregim, ashtu si në të tjerat dialogje është ngjeshur në pak fjalë urtësia dhe mençuria e popullit që shpreh kulturën, filozofinë dhe të folmen e vyer të një treve, që meriton një vëmendje të veçantë. Në dukje duket si një zhargon i një komuniteti, por në trajtimin e vështrimin letrar mbart vlera të jashtëzakonshme. Prandaj për të qënë më të qarta po mendohejmi të japim disa shpjegime, që mendojmë se janë të nevojshme.

Sqarime:

1. Shumë kohë më parë burrat i quanin gratë e tyre dhe i thirrnin sipas fshatit, fisit a derës nga ishin bijë: Lurë (kur ishte nga Lura, Reçe (kur ishte nga Reçi), xhedike (si në rastin tonë, kur ishte nga fisi Xhediku). Ky eufemizëm ishte dhe një lloj respekti që kishte burri për gruan.

"Thuaj të marrë kosën...." = Të është rritur mbesa e ma kërkojnë për nuse, do të japësh vlerësimin për tri

kërkesat që kanë mbërritur.....

2. Njitash, o fat! = Është shprehja e një respekti të thellë që ushqente grua për burrin. Ishte fati i saj me të cilën kishte lidhur jetën përfundimisht.

3. "A në derë e brenda...." = A është fjala për mbesën time, apo më kërkon për të dhënë ndonjë mendim për dikë tjetër. Tufa i kërkon Bimit ta sqarojë mirë, t'i heqë mjegullën sysh.

4. Tri shtëpi të mira ia kishin kërkuar vajzën për nuse Bim Panës, njëra që ishte më e pasur se ai, një që ishte, apo e mbante vetën më të ditur dhe shtëpia e Krrashit që ishte "akran" me të.

Shpjegim i shkurtër i disa fjalëve:

1. Shefak = mëngjes i hershëm
2. Fitos = mënyrë e lidhjes së shamisë nga gratë, për të nxjerrë në dukje xullufet, zylyfet.

3. Krahjetë-a, at, em. = fshesë e bërë me fegë meshtekne për të fshirë oborret e shtëpisë.

4. Poren-i, et, em. = rrethim i gjelbër i arave, livadheve, etj

5. Akran-i, et, em. = një moshe, të një viti, të rritur bashkë, të njëlojtë

BOTIME TË AUTORËVE DIBRANË

Shpëtim Cami

Heroi i Shtangës



MONOGRAFI

Rikthet pas 47 vjetrit të Shqipërisë

Tiranë, prill 2007

Demir Rusi

DJALI QË BLEU NJE MILION VDEKJEN

(Refimi i një emigranti)



AMC dhe UNICEF kontribut për arsimin e kulturën, në hapjen e bibliotekave të reja për fëmijët në Dibër


Dibra është destinacioni më i fundit i projektit "Shqipëria Lexon", për plotësimin me biblioteka të disa shkollave të këtij qarku. Pas shkollave në Gjirokastrë, Berat, Lushnjë, ky projekt bën të mundur plotësimin me biblioteka edhe për pesë shkolla në qarkun e Dibrës. Në vazhdim të projektit "Shqipëria lexon", i inicuar nga UNICEF dhe i realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, AMC po ndjek me kujdes të vecantë realizmin e këtij projekti.

Janë shkollat në, Katund te Ri, Qafe Murre, Lunare dhe Sillove, ku tashmë fëmijët do të kenë mundësi të lexojnë libra në bibliotekat e dhuruara.

Në ceremoninë e organizuar për këtë qëllim merrnin pjesë përfaqësues të AMC, UNICEF, si dhe drejtorisë arsimore të Dibrës, përfaqësues të pushtetit vendor, prindër të fëmijëve, etj.

Projekti "Shqipëria lexon" po realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Kjo iniciativë filloi në vitin 2006 dhe synon pajisjen e çdo shkollë publike me një bibliotekë. Përpjekjet për të rihapur bibliotekat e shkollave janë pjesë e strategjisë për reformë, që po zbatohet për të përmirësuar cilësinë e arsimit në Shqipëri.


Përveç kësaj iniciative, nëpër shkolla po ngrihen dhe inkurajohen të tjera aktivitete mbështetëse që përfshijnë këndet e leximit për komunitetin, trajnim të mësuesve, krijimin e një reviste për fëmijë, vendosjen e standardeve për literaturë cilësore dhe takime për fëmijë.



Shkatërrohet kisha e vjetër e Tallamazit

Shkatërrohet kisha e vjetër e Tallamazit, pranë fshatit Shullan të Kalasë të Dodës në Dibër, pasi asnjë nuk investon. Sipas insitutit të Arkeologjisë, bëhet fjalë për prishjen e një monumenti kulti të periudhës paleobizantine të shek. XIII-XIV, e pikturuar me afreske. Sipas Insitutit, për të shkuar deri tek monumenti dhe pastaj për të kryer aktin e shkatërrimit, persona të pa identifikuar kanë shpezuar aq shumë, sa vështirë se me "thesarin" imagjinar që do të gjenin aty, do të mbulonin shpenzimet e bëra. Për këtë veprim, ata kanë pastruar rreth 1.5 kilometra rrugë malore, pastaj kanë çuar fadromën dhe kanë shkatërruar monumentin, ku nuk kanë gjetur asnjë thesar të imagjinuar. Kështu, përveç prishjes së kishës, janë dëmtuar edhe pikturat murale të saj. Deri tani asnjë nuk ka investuar për të bërë restaurimin e këtij monumenti kulturor. Kjo ka bërë që persona të ndryshëm të zhdukin pak nga pak trashëgimin arkeologjike, etnografike, kulturore shqiptare. Kjo sjell më pas edhe humbjen e vlerave kulturore të këtij vendi. (Tirana Observer)

Sulejman Tomçini sjell në shqip fabula të vjetra indo-persiane



Botimet "m&b"

ISBN 978-99943-968-3-2

Libri "Kalila dhe Dimna" u shkrua nga dijetarët e Indisë. Që nga ajo kohë, shkencëtarët dhe dijetarët e të gjitha vendeve janë përpjekur të mësojnë dhe të mençurohen prej tij dhe kanë vrapsur të vënë në jetë mësimet dhe përvojat që përmban ky libër. Ata janë përpjekur që, me anën e këtij libri, të gjejnë dhe shërojnë të metat e tyre, pavarësisht se tregimet dhe historitë janë vënë në gojën e kafshëve dhe të zogjve, duke u dhënë atyre veti njerëzore.

Libri përmban në vetvete njohuri dhe kulturë të gjerë, si dhe mjaft histori argëtuese. Dijetarët e vlerësonin dhe e kërkonin atë, pikërisht për këto njohuri, ndërsa njerëzit e zakonshëm për anën e tij argëtuese. Njerëzit e arsimuar, që ranë në kontakt me tregimet e këtij libri, u përpoqën të mbanin mend ngjarjet, me qëllim që t'i lidhnin me jetën dhe përvojën e tyre.